www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2024 – Numri: 199

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 26 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 110/2024, datë 31.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë".....	21821
Dekret i Presidentit nr. 393, datë 20.11.2024	Për shpallje ligji.....	21824
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 20.11.2024	Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale".....	21824
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 20.11.2024	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të një pjese të pasurisë me nr. 5/102 dhe të pasurisë me nr. 5/251, në zonën kadastrale 8160, Tiranë.....	21836
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 20.11.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 965, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të pronës me nr. 37, me emërtimin 'Ministria e Mbrojtjes', me vendndodhje në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes', të ndryshuar".....	21840
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 20.11.2024	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të pronës me emërtimin "Spitali Rajonal Vlorë" dhe për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 717, datë 1.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", të ndryshuar.....	21840

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 715, datë 20.11.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 219, datë 16.4.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Albpetrol sh.a.", të ndryshuar.....	21844
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 20.11.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh–Marinëz dhe linjës Ballsh–Drenovë".....	21854
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 718, datë 20.11.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar.....	21855
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 20.11.2024	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Uzbekistanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.....	21863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 720, datë 20.11.2024	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Republikës së Kirgizstanit, për përjashtimin e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.....	21866
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 20.11.2024	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Nikaraguas, për përjashtimin e vizave për pasaportat e zakonshme, diplomatike dhe të shërbimit.....	21868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 20.11.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1139, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe të planit të veprimit 2021–2023".....	21870
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 20.11.2024	Për autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare, për koordinimin e procesit të identifikimit të pronës shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi në fshatin Vrinë, Bashkia Konispol.....	21890
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 724, datë 20.11.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.....	21891
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 726, datë 20.11.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 61, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kërkesave e të kritereve që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblimit të anëtarëve të tyre".....	21896

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 727, datë 20.11.2024	Për një shtesë në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", të ndryshuar.....	21896
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 728, datë 20.11.2024	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.....	21896
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 250, datë 25.10.2024	Për miratimin e rregullores "Për modalitetet e llogaritjes së kostos që shkaktohet drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të trenave dhe aplikimit të tarifimit për koston e efekteve të zhurmës".....	21897
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 98, datë 23.2.2024	Për përcaktimin e formatit të licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore.....	21903
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 99, datë 23.2.2024	Për miratimin e rregullores për organizimin e punës dhe veprimtarisë së komisionit të licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për kultivimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore.....	21904
Autorizim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 22.10.2024		21909
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 882/14, datë 18.11.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 702, datë 4.11.2022, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV, Valias'"	21910
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1184/11, datë 19.11.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve *Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës*, loti 1&QMT, faza 2".....	21910

LIGJ
Nr. 110/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 435, DATË 23.6.2011, "PËR SHËRBIMIN E KËRKIM-SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet dhe bëhet "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit (SAR) në Republikën e Shqipërisë në rast aksidentesh ajrore dhe detare".

Neni 2

Në nenin 1 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas fjalëve "shërbimit të kërkim-shpëtimit" shtohet shkurtesa "SAR".

2. Fjalët "fatkeqësish të ndryshme" zëvendësohen me fjalët "aksidentesh të ndryshme ajrore, detare dhe në ujërat e brendshme".

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "ARCC" është Qendra Ajrore e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet aeronautike të kërkimit e të shpëtimit.

b) "Emergjenca SAR" është situata e krijuar në rastet e aksidenteve të ndryshme ajrore dhe detare që nënkupton, sipas rastit, një fazë emergjence SAR.

c) "Faza e emergjencës SAR" është situata që tregon, sipas rastit, fazë pasigurie, alarmi ose rreziku të vendosura e të pranuara nga autoritetet ndërkombëtare detare dhe ajrore të ICAO/IMO, nëpër të cilat kalon klasifikimi i incidentit SAR dhe përcaktimi i veprimeve që do të ndërmerren.

ç) "Faza e paqartësisë/pasigurisë" është një situatë kur ekziston paqartësia për sigurinë e mjetit ajror/detar dhe të personave në bordin e tij.

d)"Faza e alarmit" është një situatë kur mendohet se mjeti ajror/detar dhe personat në bordin e tij ose njësia tokësore janë të pasigurta.

dh) "Faza e rrezikut" është situata në të cilën ekziston një bindje e arsyeshme dhe është e sigurt se personi/personat apo mjeti ajror/detar dhe personat në bordin e tij gjenden në rrezik serioz ose kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme.

e) "ICAO" është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

ë) "IMO" është Organizata Ndërkombëtare Detare.

f) "JRCC" është Qendra e Përbashkët e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet aeronautike dhe detare të kërkimit e të shpëtimit.

g) "KKAKSH" është Koordinatori Kombëtar Ajror i Kërkimit e Shpëtimit.

gj) "KKDKSH" është Koordinatori Kombëtar Detar i Kërkimit e Shpëtimit.

h) "Mjet detar SAR" është mjeti detar i destinuar për operacione SAR, me pajisje dhe personel të nevojshëm për operacionet detare SAR.

i) "Mjet ajror SAR" është mjeti ajror i konfiguruar për misione kërkim-shpëtimi.

j) "MRCC" është Qendra Detare e Koordinim-Shpëtimit, përgjegjëse për operacionet detare të kërkimit e të shpëtimit.

k) "Njësi shpëtimi SAR" janë njësitë e përbëra nga personel i stërvitur e i kompletuar me mjetet dhe pajisjet e përshtatshme për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

l) "Operacione ndërhyrjeje SAR" janë veprimet për shpëtimin e jetës së njerëzve, në raste aksidentesh të ndryshme, ajrore, detare edhe në ujërat e brendshme.

ll) "Rajoni i kërkim-shpëtimit SAR" është një zonë e përcaktuar brenda së cilës sigurohen shërbimet e kërkim-shpëtimit.

m) "RCC" është Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, njësi përgjegjëse e organizimit të shërbimeve të kërkim-shpëtimit dhe për koordinimin e kryerjes së operacioneve të kërkimit e të shpëtimit brenda një rajoni kërkimi dhe shpëtimi.

n) "SAR" është shërbimi i kërkim-shpëtimit, në raste aksidentesh të ndryshme, ajrore, detare dhe në ujërat e brendshme, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet e procedurat për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

nj) "Subjekte private" janë subjektet e përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 4

Pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 4 ndryshohen si më poshtë:

"2.Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë. KKKSH-ja drejton dhe koordinon operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, e cila luan dhe rolin e Qendrës së Përbashkët të Koordinim-Shpëtimit (JRCC).

3. Komandanti i Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë është Koordinator Kombëtar Ajror i Kërkim-Shpëtimit (KKAKSH). KKAKSH-ja drejton dhe koordinon operacionet nëpërmjet Qendrës Ajrore të Kërkim-Shpëtimit (QAJKSH), e cila kryen dhe rolin e Qendrës Ajrore të Koordinimit të Shpëtimit (ARCC).

4. Komandanti i Forcës Detare të Republikës së Shqipërisë është Koordinator Kombëtar Detar i Kërkimit-Shpëtimit (KKDKSH). KKDKSH-ja drejton dhe koordinon operacionet nëpërmjet Qendrës Detare të Kërkim-Shpëtimit (QKDKSH), e cila kryen edhe rolin e Qendrës Detare të Koordinimit të Shpëtimit (MRCC).".

Neni 5

Pas nenit 4 shtohen nenet 4/1 dhe 4/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit

1. Në Ministrinë e Mbrojtjes ngrihet dhe funksionon Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit, i cili është organ i përhershëm dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave e të strategjive në fushën e kërkim-shpëtimit SAR.

2. Përbërja dhe detyrat e Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

Neni 4/2
Funksionet mbikëqyrëse të shërbimit të kërkim-shpëtimit

1. Autoriteti i Aviacionit Civil ngarkohet për mbikëqyrjen e shërbimit të kërkimit dhe shpëtimit për sa u takon funksioneve të ofrimit të shërbimit SAR, në situata emergjence të avionëve apo personave përkatës në bord të avionit.

2. Për të siguruar ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

3. Për të siguruar ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil pajisen me kredenciale nga drejtori ekzekutiv, në përputhje me parashikimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.".

Neni 6

Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët "qëllim planëzimin, organizimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit." zëvendësohen me fjalët "mision menaxhimin dhe koordinimin në nivel kombëtar të operacioneve të kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, në raste aksidentesh ajrore dhe detare.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Standardet për shërbimin e kërkim-shpëtimit, në përputhje me aneksin 12 të Konventës

Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për transportin.”.

Neni 7

Në pikën 1 të nenit 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Emërtimi “Qendrës së Koordinimit të Shpëtimit (RCC)” zëvendësohet me emërtimin “Qendrës së Përbashkët të Koordinimit të Shpëtimit (JRCC)”.

2. Në shkronjën “c” pas fjalës “drejton” shtohen fjalët “dhe koordinon”.

3. Në shkronjën “ë” pas emërtimit “Ministrisë së Mbrojtjes” shtohen fjalët “ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë”.

Neni 8

Në pikën 1 të nenit 8 pas emërtimit “Ministria e Mbrojtjes” shtohen fjalët “ministria përgjegjëse për shëndetësinë”.

Neni 9

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “b” dhe “c” shfuqizohen.

2. Në shkronjën “ç” fjalët “dhe Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve” hiqen.

Neni 10

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1, “Ministria përgjegjëse për shëndetësinë”, me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1
Ministria përgjegjëse për shëndetësinë

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, përveç detyrimeve që rrjedhin nga akte të tjera ligjore, nënligjore, në zbatim të këtij ligji kryen edhe këto detyra:

a) mbështet me kapacitetet e saj operacionet e kërkim-shpëtimit;

b) bashkërendon veprimet me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes;

c) kontribuon nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj për ndihmën e parë shëndetësore dhe transportin e të plagosurve.”.

Neni 11

Pikat 1 dhe 2 të nenit 13 ndryshohen si më poshtë:

“1. Për vendet e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje, leja për hyrjen dhe daljen e mjeteve ajrore, lundruese e të mjeteve të njësive tokësore të shërbimit të kërkim-shpëtimit, me mision kërkim-shpëtimin, pas kërkesës së autoriteteve kompetente, jepet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit.

2. Për vendet e huaja me të cilat nuk është lidhur marrëveshje, leja për hyrjen dhe daljen jashtë vendit të mjeteve ajrore, lundruese e të mjeteve të njësive tokësore të shërbimit të kërkim-shpëtimit, me mision kërkim-shpëtimin, pas kërkesës për ndërhyrje të autoriteteve kompetente, jepet nga ministri i Mbrojtjes.”.

Neni 12

Në nenin 16 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Burimet e financimit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit janë:

a) buxheti i shtetit;

b) fondi për kërkim-shpëtimin, i krijuar në Albcontrol;

c) burime dhe donacione të tjera të ligjshme.”.

2. Në pikën 2 pas emërtimit “Ministria e Brendshme” shtohen fjalët “ministria përgjegjëse për shëndetësinë”.

3. Në pikën 3 fjalët “e nenit 90 të ligjit nr. 10 040, datë 22.10.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.” zëvendësohen me fjalët “e nenit 98 të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 13

Kudo në ligj bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “ministria/ministrinë/ministrisë përgjegjëse për punët publike dhe transportin” zëvendësohen me fjalët “ministria / ministrinë / ministrisë përgjegjëse për transportin”.

2. Emërtimi “Ministria/Ministrisë e/së Brendshme” zëvendësohet me fjalët “ministria / ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë”.

3. Fjalët "ministria/ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave" zëvendësohen me fjalët "ministria/ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe pyjet".

Neni 14

Në nenin 17 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas fjalës "neneve" shtohet togfjalëshi "4/1, pika 2".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri përgjegjës për transportin të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.".

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.10.2024.

Shpallur me dekretin nr. 393, datë 20.11.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 393, datë 20.11.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 110/2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 435, datë 23.6.2011, 'Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë'".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 711, datë 20.11.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË, NË KUADËR TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, e 12, pikat 2 e 6, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 392, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale', i ndryshuar", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKë, në kuadër të OFRIMIT TË asistencës juridike, ROLIn e AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMAT E POSAÇME PROCEDURALE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për:

a) marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë, të parashikuar në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar (në vijim "personat juridikë");

b) rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në gjyq të avokatëve të shtetit pranë personave juridikë, për procedurat e posaçme për ushtrimin e aktivitetit të avokatëve të shtetit, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale;

c) marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë publikë në kuadër të këshillimit;

ç) kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e së drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit te personi juridik i interesuar;

d) mënyrën e bashkërendimit të punës së avokatëve të shtetit me personat juridikë, të cilëve u ofrohet asistenca juridike, si dhe raportet ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe titullarëve të institucioneve;

dh) marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionet, të cilët detyrohen t'i vijnë në ndihmë avokatit të shtetit, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike;

e) çështjet ekonomike dhe shpenzimet e procesit.

Neni 2
Parimet e bashkëpunimit

1. Strukturat e Avokaturës së Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit, garantojnë zbatimin me përgjegjësi dhe korrektësi të legjislacionit në fuqi, njësimin e praktikës juridike dhe unitetin e doktrinës, pavarësinë profesionale dhe autonominë teknike, si dhe këshillimin e drejtë, mbrojtjen dhe përfaqësimin sa më të mirë të interesave publikë.

2. Avokatura e Shtetit gjatë bashkëpunimit udhëhiqet nga parimet e ekskluzivitetit, profesionalizmit, eficiencës, përgjegjësisë në zbatimin e ligjit, si dhe konfidencialitetit.

Neni 3
Dhënia e asistencës juridike

Avokatura e Shtetit jep ekskluzivisht asistencë juridike në formën e këshillimit dhe të përfaqësimit në gjykata për personat juridikë nëpërmjet:

a) ofrimit të shërbimit këshillimor, sipas parashikimeve ligjore;

b) përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave pasurorë në gjykatat kombëtare, ndërkombëtare e të huaja dhe arbitrazhin ndërkombëtar në të gjitha shkallët e gjykimit;

c) mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit nëpërmjet ngritjes së padisë civile në procesin penal;

ç) unifikimit të praktikës juridike;

d) ndërmjetësimit për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve, ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike;

dh) ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit;

e) ndërmarrjes së veprimeve për shfuqizimin e akteve juridike dhe kontratave administrative, nëpërmjet autorizimit paraprak nga personi juridik, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

ë) paraqitjes së kërkesës për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Neni 4
Refuzimi i dhënies së asistencës juridike

1. Avokatura e Shtetit nuk jep asistencë juridike, në rastet e mëposhtme:

a) në çështjet gjyqësore, ndërmjet organeve qendrore të administratës publike;

b) në çështjet gjyqësore, ndërmjet organeve të qeverisjes vendore, kur asistenca juridike ofrohet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme midis Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore;

c) në çështjet gjyqësore, ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe organeve të qeverisjes vendore për organet e qeverisjes vendore, pavarësisht, nëse ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe

organeve vendore mund të ketë një marrëveshje të posaçme për ofrimin e asistencës juridike;

ç) për hartimin e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike dhe çështjeve gjyqësore, që lidhen me këto procese, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;

d) në çështjet gjyqësore, në të cilat mosmarrëveshja është midis palëve private, pavarësisht, nëse palë ndërgjyqëse është edhe një person juridik publik.

2. Avokatura e Shtetit, kur konstaton se gjendet në një prej rasteve të ndaluara, njofton menjëherë organin procedues dhe personin juridik publik, që ka kërkuar asistencë juridike, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme për garantimin e të drejtës së mbrojtjes.

Neni 5

Bashkërendimi i punës së Avokaturës së Shtetit me personat juridikë

1. Çdo person juridik, të cilit i ofrohet shërbimi i përfaqësimit nga Avokatura e Shtetit, duhet të ofrojë bashkëpunimin që do të kërkohet për të bërë efektiv funksionin e avokatëve të shtetit, duke siguruar njëkohësisht respektimin e afateve ligjore apo të afateve të caktuara nga organet përkatëse për kryerjen e veprimeve procedurale.

2. Detyrimi për bashkëpunim përfshin kryesisht, por pa u kufizuar, vënien në dispozicion të dokumentacionit, sqarimeve dhe informacioneve të nevojshme për shqyrtimin e çështjes, hartimin e raporteve lidhur me aktet ose veprimet që cenojnë interesat e personave juridikë, të asistuar nga Avokatura e Shtetit.

3. Personi juridik është i detyruar, që brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës pranë institucionit, t'i përcjellë Avokaturës së Shtetit të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e kërkuara.

4. Çdo person juridik, i cili merr asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit, cakton një punonjës, si person kontakti, përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit me Avokaturën e Shtetit. Nëse personi juridik është i organizuar me zyra qendrore dhe vendore, cakton person kontakti në secilin nivel organizimi.

5. Për ata persona juridikë, që kanë në strukturën e tyre drejtori apo sektor të posaçëm, që mbulojnë përfaqësimin në gjykatë, person kontakti, sipas rastit, do të jetë drejtuesi ose përgjegjësi i kësaj strukture. Nëse personi juridik nuk ka në strukturën juridike një pozicion të tillë, titullari emëron, si person kontakti, një nëpunës të profilit jurist, i cili është i ngarkuar me përfaqësimin në gjykatë të institucionit.

6. Titullari i çdo personi juridik i njofton zyrtarisht me shkresë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, të dhënat e kontaktit të personit ose personave të caktuar, si person kontakti, për mbajtjen e marrëdhënies me Avokaturën e Shtetit, në varësi të formës së organizimit.

7. Personi i kontaktit për Avokaturën e Shtetit pranë personave juridikë është përgjegjës dhe ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin e shtetit të caktuar për dhënien e asistencës juridike pranë atij institucioni, me qëllim sigurimin e dhënies së asistencës juridike në interesin më të lartë të shtetit.

8. Personi i kontaktit zhvillon takime pune, të paktën një herë në muaj, me avokatin e shtetit për koordinimin dhe diskutimin e çështjeve, të cilat paraqesin interes të veçantë. Me kërkesë të avokatit të shtetit, mund të zhvillohen takime pune, sa herë që del e nevojshme.

9. Në rast se avokati i shtetit vlerëson se afatet ligjore, procedurale apo ato të vendosura nga gjykata diktojnë urgjencë, përveç komunikimit shkresor, si më sipër, kontakton menjëherë në rrugë elektronike me personin e kontaktit të personit juridik, që do të përfaqësohet në gjykatë, duke i sqaruar nevojën dhe urgjencën, si dhe duke i kërkuar përcjelljen elektronike të të gjitha dokumenteve, informacioneve apo sqarimeve të nevojshme, brenda afatit të caktuar.

10. Për veprimet procedurale të ngutshme, për të cilat ka ardhur në dijeni përfaqësuesi ligjor i personit juridik apo është njoftuar nga Avokati i Shtetit, ka detyrimin që menjëherë dhe jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike, të njoftojë Avokaturën e Shtetit dhe të dërgojë materialet e nevojshme për realizimin e përfaqësimit dhe mbrojtjes.

11. Personi juridik për çdo çështje gjyqësore, për të cilën përfaqësohet nga Avokatura e Shtetit, i dërgon kësaj të fundit, së bashku me dokumentet e kërkuara si më sipër, edhe një raport të hollësishëm për gjendjen e fakteve, të ligjit, si dhe qëndrimin zyrtar të institucionit për çështjen konkrete.

12. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton titullarin e personit juridik për shkeljen e detyrimeve të parashikuara në këtë rregullore.

13. Mosrespektimi i afateve, të përcaktuara në këtë rregullore, në lidhje me bashkërendimin e punës nga ana e personave juridikë, që u ofrohet asistencë juridike apo institucionet e tjera që duhet të ofrojnë shërbime, informacione, dokumentacion apo sqarime në ndihmë të funksioneve të Avokaturës së Shtetit, pa shkaqe të arsyeshme, apo krijimi i qëllimshëm i pengesave për shkeljen e tyre, përbën shkak për marrjen, sipas rastit, të masave disiplinore, masave administrative, civile dhe penale ndaj personave përgjegjës.

14. Në rast se nga personat juridikë nuk respektohet detyrimi për bashkëpunim, Avokatura e Shtetit njofton Kryeministrin.

KREU II
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË PËRFAQËSIMIT DHE MBROJTJES NË GJYKIM

Neni 6
Rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në gjyq nga Avokatura e Shtetit

Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:

a) Përfaqëson ekskluzivisht personat juridikë, të përcaktuar në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë;

b) U jep mendim të specializuar organeve të administratës shtetërore dhe enteve publike, kur i kërkohet prej tyre;

c) Ndërmjetëson zgjidhje me marrëveshje të konflikteve, që lindin ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike, të parashikuara në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, kur kjo kërkohet nga palët;

ç) Ka të drejtën e nisjes së veprimeve ligjore, me qëllim për të shfuqizuar aktet juridike dhe kontratat administrative, si edhe për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural dhe në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me autorizim paraprak të organit administrativ të interesuar, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

d) Ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

dh) Ka të drejtë të bëjë kërkesë për rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë për çështje që ka interes pasuror shteti shqiptar;

e) Ka të drejtë të bëjë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të një autorizimi të posaçëm dhe në përputhje me normat ligjore në fuqi.

Neni 7
Procedura e përfaqësimit

1. Në rastet e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit në gjykim, Avokatura e Shtetit zbaton legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në këto raste, Avokatura e Shtetit respekton rregullat për marrjen e kërkesës së motivuar nga organi i interesuar për t'u përfaqësuar në gjykim, pa qenë e nevojshme marrja e një autorizimi të posaçëm të të përfaqësuarit.

2. Avokatura e Shtetit mund të kryejë procedura të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore, kur është në interes të zgjidhjes së çështjes, objekt gjykimi, dhe me miratim të personit juridik të interesuar, por gjithmonë duke respektuar dispozitat ligjore procedurale.

3. Në çdo rast, Avokatura e Shtetit, në përpilimin e akteve drejtuar organeve gjyqësore, respekton kërkesat formale të legjislacionit procedural.

Neni 8
Kriteret lëndore dhe sasiore për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes

1. Delegimi i të drejtës së përfaqësimit në gjykim nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme, kur:

a) vlera e objektit të padisë së çështjes objekt gjykimi është më e vogël se 2 (dy) milionë lekë;

b) objekt gjykimi janë marrëdhëniet e punës ndërmjet institucioneve dhe personave të tretë, pavarësisht, shkronjës "a" të kësaj pike;

c) në rastet e mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal, vlera e dëmit material është më e vogël se 2 (dy) milionë lekë;

ç) sipas statistikave, ka një numër të konsiderueshëm çështjesh të ngjashme nga i njëjti institucion dhe praktika juridike është njësuar;

d) objekt mosmarrëveshjeje është konflikti midis palëve private, pavarësisht, nëse palë ndërgjyqëse është një institucion shtetëror;

dh) objekt i mosmarrëveshjes janë akte administrative, pa vlerë financiare.

2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, kur vlerëson se delegimi i së drejtës së përfaqësimit është i mundshëm, në bazë të kritereve të njësimit të praktikës nga Avokatura e Shtetit dhe/ose për çështje me karakter të veçantë, ka të drejtë të vendosë delegimin e përfaqësimit në gjykim.

Neni 9
Delegimi i përfaqësimit dhe i mbrojtjes

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, kryesisht ose nëpërmjet Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, të caktuar për përfaqësimin e një çështjeje, mund ta delegojë të drejtën e përfaqësimit të interesave të shtetit në gjykim te personi juridik i interesuar.

2. Për çështjet që janë deleguar me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, avokati i shtetit njofton gjykatën për delegimin e çështjes. Këtë njoftim, avokati i shtetit e përcjell në rrugë elektronike, brenda ditës edhe te personi i kontaktit të personit juridik për Avokaturën e Shtetit.

3. Kur gjatë gjykimit, nga ana e përfaqësuesit të personit juridik konstatohet se, ka ndryshuar objekti i mosmarrëveshjes gjyqësore ose pozita procedurale e palëve dhe çmohet i nevojshëm përfaqësimi nga Avokatura e Shtetit, duhet të njoftojë me shkrim dhe në rrugë elektronike nëpërmjet personit të kontaktit, për marrjen e masave për përfaqësimin në gjykim. Për këtë rast, Avokatura e Shtetit ka të drejtën të shprehet për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga paraqitja e saj, nëpërmjet postës elektronike.

4. Pavarësisht delegimit të përfaqësimit dhe mbrojtjes së çështjes te personi juridik i interesuar, hartimi i rekursit dhe përfaqësimi në Gjykatën e Lartë do të bëhet nga Avokatura e Shtetit, pas kërkesës së bërë nga personi juridik.

5. Për çështjet që janë deleguar dhe që Avokatura e Shtetit nuk ka marrë pjesë në gjykim përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë duhet të përcjellin qëndrimin me shkrim dhe informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm pranë Avokaturës së Shtetit, në mënyrë që të ushtrohet e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë.

Neni 10
Detyrimi i pranimit të delegimit

Personi juridik, të cilit i delegohet e drejta e përfaqësimit të interesave të shtetit në gjykim, nuk mund ta refuzojë përfaqësimin dhe mbrojtjen për çështjen e deleguar, me përjashtim të rasteve të konfliktit të interesit. Konflikti i interesit për përfaqësim i njoftohet menjëherë me shkrim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 11
Detyrimi për unifikimin e qëndrimit në përfaqësimin ligjor të personave juridikë

1. Personat juridikë, për të cilët Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike, kanë detyrimin për t'i njoftuar avokatit të shtetit, të caktuar për përfaqësimin në gjykim, qëndrimin e tyre me shkrim dhe provat, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga njoftimi i kërkesës për gjykim apo fillimi i afatit për paraqitjen e akteve në gjykatë.

2. Në çështjet gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike sipas ligjit, personat juridikë publikë kanë detyrimin të unifikojnë qëndrimin dhe strategjinë e mbrojtjes me avokatin e shtetit, të caktuar për ndjekjen e çështjes.

3. Në rastet kur avokati i shtetit konstaton moszbatimin e kësaj dispozite, njofton menjëherë Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe titullarin e personit juridik që përfaqësohet, për marrjen e masave, sipas pikave 12, 13 dhe 14, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

4. Përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë nuk duhet të depozitojnë akte në gjykatë, të cilat janë të ndryshme nga qëndrimi i mbajtur nga Avokatura e Shtetit, me përjashtim të rasteve kur janë palë kundërshtare në gjykim. Për çdo rast, personat juridikë, përpara depozitimit të akteve duhet të

konsultohen me avokatin e shtetit, të caktuar për ndjekjen e çështjes.

Neni 12
Përfaqësimi

1. Interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, si dhe organeve të tjera në çështjet gjyqësore, në të cilat një institucion shtetëror, ent publik ose Republika e Shqipërisë është palë, përfaqësohen dhe mbrohen nga Avokatura e Shtetit.

2. Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, në nivelin qendror të Avokaturës së Shtetit, përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës.

3. Zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare, në nivelin qendror në Avokaturën e Shtetit, përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese.

4. Avokatët e shtetit pranë ministrive përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit në çështjet gjyqësore, të cilat kanë për objekt:

a) mbrojtjen e interesave pasurorë të ministrive;

b) mbrojtjen e interesave pasurorë të institucioneve në varësi të ministrive.

5. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat pasurorë të shtetit në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, sipas organizimit territorial dhe kompetencave tokësore, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13
Përfaqësimi në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit

1. Për çështjet gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e personave juridikë, gëzon ekskluzivitetin për të vendosur për mënyrën dhe strategjinë e mbrojtjes.

2. Avokatura e Shtetit ka të drejtë të paraqesë në gjykim çdo lloj kërkese, sipas ligjit, që shërben për realizimin e një mbrojtjeje efektive, përfshirë kundërpadi, kërkesa për pezullim, kompetencë dhe juridiksion. Në rastin e paraqitjes së kundërpadisë, personi juridik, të cilit i ofrohet asistenca juridike, duhet të pajisë Avokaturën e Shtetit me autorizimin përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e depozitimit në gjykatë.

3. Përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë duhet t'i njoftojnë Avokaturës së Shtetit, qëndrimin e tyre me shkrim, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga komunikimi i akteve nga gjykata.

4. Përfaqësuesit e personit juridik, në rastet kur marrin pjesë në gjykim, përpara se të paraqesin çdo lloj akti përfaqësimi në gjykatë, duhet të konsultohen më parë me avokatin e shtetit, që ka në ndjekje çështjen gjyqësore, dhe vetëm pas miratimit të strategjisë së mbrojtjes kanë të drejtë të paraqesin akte në gjykatë. Miratimi i strategjisë së mbrojtjes mund të jepet nëpërmjet postës elektronike dhe jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga përfundimi i afatit të depozitimit të mbrojtjes.

5. Të gjitha aktet procedurale, që do të paraqiten në gjykatë, duhet të jenë të koordinuara dhe qëndrimi i përfaqësuesve ligjorë të personave juridikë duhet të jetë i njëjtë me qëndrimin dhe mbrojtjen e Avokatit të Shtetit, i cili ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë në qëndrimin e personit juridik publik, me qëllim unifikimin e strategjisë së mbrojtjes.

Neni 14
Paraqitja e rekursit

1. Avokatura e Shtetit paraqet rekurs në Gjykatën e Lartë për të gjitha çështjet gjyqësore, në të cilat ka ushtruar përfaqësim ligjor në shkallët e mëparshme të gjykimit apo që ushtron përfaqësim, sipas ligjit.

2. Për çështjet gjyqësore, për të cilat Avokatura e Shtetit ka deleguar të drejtën e përfaqësimit, dhe nga ana e personave juridikë çmohet se duhet ushtruar e drejta e rekursit, përgatitja, nënshkrimi dhe depozitimi i tij do të kryhen nga Avokatura e Shtetit, e asistuar nga përfaqësuesit e personave juridikë, të cilët duhet të paraqesin qëndrimin e arsyetuar për shkaqet e ushtrimit të rekursit, sipas ligjit.

3. Për çështjet gjyqësore, ku Avokatura e Shtetit ka refuzuar të drejtën e përfaqësimit, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, nuk do të ofrohet asistenca juridike nga ana e Avokaturës së Shtetit.

4. Për realizimin e përfaqësimit dhe të mbrojtjes efektive, personat juridikë duhet të ofrojnë bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre, në kuadër të dërgimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit për çështjet gjyqësore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit dhe 3 (tri) ditë kalendarike për rastet e rekurseve të veçanta.

5. Rekursi, për çdo rast, nënshkruhet nga Avokatura e Shtetit, pa qenë nevoja e nënshkrimit të tij nga personi juridik që përfaqësohet, i cili mund të nënshkruajë në rekurs, nëse e kërkon shprehimisht me shkrim.

6. Personi juridik ka të drejtën të shprehet për mosparaqitjen e rekursit, por në çdo rast, qëndrimi duhet të jetë i arsyetuar dhe me shkrim dhe t'i njoftohet Avokaturës së Shtetit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

7. Në rastet kur personi juridik shprehet për mosparaqitjen e rekursit ose heqjen dorë nga rekursi, ky qëndrim i njoftohet zyrtarisht Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit, pasi vlerëson situatën ligjore, vendos për kërkesën për mosushtrimin ose heqjen dorë nga e drejta e rekursit.

Neni 15
Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë

1. Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, sipas ligjit.

2. Për rastet, kur Gjykata e Lartë njofton personin juridik drejtpërdrejt apo nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, për kthimin e rekursit për plotësimin e të metave, sipas neneve 474 dhe 476, të Kodit të Procedurës Civile, personi juridik përkatës është i detyruar të njoftojë menjëherë Avokaturën e Shtetit, në rrugë elektronike, nëpërmjet *e-mail*-it zyrtar drejtuar personit të kontaktit, dhe në rrugë shkresore drejtuar Avokaturës së Shtetit.

Neni 16
Paraqitja e ankimit kushtetues individual

1. Në rastet kur çmohet se ka shkaqe të ligjshme për të paraqitur ankim individual pranë Gjykatës Kushtetuese, Avokatura e Shtetit njofton personin juridik, brenda një periudhe prej 2 (dy) muajve nga dhënia e vendimit, për dhënien e mendimit me shkrim.

2. Pas dhënies së mendimit me shkrim, nga ana e Avokaturës së Shtetit dërgohet kërkesa për dhënien e autorizimit, e cila përmban shkaqet ligjore për paraqitjen e ankimit kushtetues ndaj vendimit gjyqësor.

3. Personi juridik, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i kërkesës për dhënie autorizimi, ka të drejtën për dhënien e autorizimit përkatës.

Neni 17
Roli i avokatit të shtetit në gjykim dhe marrëdhënia me personin juridik

1. Avokatët e shtetit, gjatë përfaqësimit të institucioneve shtetërore, mbrojnë interesat e institucionit që përfaqësojnë dhe interesat pasurorë të shtetit, gjatë të gjitha fazave procedurale që marrin pjesë.

2. Në çështjet gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin për institucionin, përfaqësuesi ligjor i këtij të fundit, i ngarkuar me ndjekjen e çështjes, bashkëpunon në mënyrë të ngushtë me avokatin e shtetit.

3. Avokatët e shtetit kanë funksion përfaqësues dhe mbrojtës të personit juridik dhe përfaqësuesit ligjorë të personave juridikë bashkëpunojnë dhe ndihmojnë në dhënien e informacionit dhe shprehjes së vullnetit të institucionit që përfaqësojnë.

KREU III
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË NGRITJES SË PADISË

Neni 18
Nisma për fillimin e procedurave administrative dhe ligjore

1. Avokatura e Shtetit ka të drejtë të fillojë procedurat për paraqitjen e kërkesëpadisë, të kundërpadisë, të kërkesës për rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë apo çdo veprimi procedural të ngjashëm, kryesisht ose me kërkesë me shkrim të motivuar të personit juridik ose entit publik të interesuar, me përjashtim të rasteve urgjente.

2. Avokatura e Shtetit, sipas kërkesës së motivuar dhe autorizimit të personit juridik të interesuar, ka të

drejtë të fillojë procedurat për ngritjen e padisë, me objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik, që tjetërson ose disponon mbi pasurinë shtetërore, në favor të të tretëve ose për shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit ose pavlefshmëri të kontratave administrative, të lidhura me të tretë ose me çdo objekt tjetër për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit.

3. Avokatura e Shtetit, përpara depozitimit të padisë në gjykatë, i paraqet personit juridik të interesuar një raport të hollësishëm me shkrim për gjendjen e fakteve dhe të ligjit, kostot e pritshme të gjykimit, si dhe për çdo shpenzim të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm apo çdo dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror, që pala tjetër mund të pretendojë ose të fitojë gjatë apo pas përfundimit të gjykimit për shpalljen e pavlefshme të kontratës ose të veprimit juridik. Ky raport mbyllet me qëndrimin e shprehur të Avokaturës së Shtetit për ngritjen ose jo të padisë.

4. Në rastet urgjente, Avokatura e Shtetit njofton menjëherë personin juridik të interesuar dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga fillimi i procedurave administrative apo gjyqësore i paraqet raportin e hollësishëm sipas pikës 3 të këtij neni. Personi juridik i interesuar, me marrjen e njoftimit dhe të raportit të hollësishëm, miraton veprimet e kryera dhe jep autorizimin me shkrim për vazhdimin ose jo të procedurës së filluar.

5. Në rast se personi juridik fillon procedurat ankimuese administrative apo gjyqësore me nismën e vet, nëpërmjet padisë apo ankimit, atëherë ai ka detyrimin për të njoftuar paraprakisht me shkrim Avokaturën e Shtetit dhe për të marrë një vlerësim ligjor për hartimin e aktit dhe strategjinë e mbrojtjes.

KREU IV
MARRËDHËNIET E AVOKATURËS SË SHTETIT ME PERSONAT JURIDIKË, NË KUADËR TË KËSHILLIMIT

Neni 19
Rastet e ushtrimit të funksioneve këshillimore nga Avokatura e Shtetit

1. Personat juridikë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, në përputhje me parashikimet ligjore, mund të kërkojnë nga Avokatura e Shtetit mendim me shkrim për çështje të karakterit juridik, të cilat mund të prodhojnë pasoja financiare për shtetin.

2. Personat juridikë mund të kërkojnë paraprakisht nga Avokatura e Shtetit mendim për projektet e kontratave, të cilat do të nënshkruhen prej tyre. Në këtë rast, Avokatura e Shtetit mund të sugjerojë paraprakisht përmbajtjen e tyre.

3. Këshillimi paraprak i personit juridik me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për t'u kërkuar, në rastet e mëposhtme:

a) Për hartimin, negocimin nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave të koncesionit, të kontratave të partneritetit publik-privat. Për kontrata të tjera publike për kryerje punimesh, furnizim mallrash dhe furnizim shërbimesh, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike;

b) Për hartimin, negocimin, nënshkrimin, ndryshimin dhe zgjidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

c) Kur shfaqen pretendime nga pala private apo institucioni publik në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në rast konflikti interpretimesh apo çdo mosmarrëveshje tjetër në ekzekutimin e kontratave, që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në arbitrazh ndërkombëtar;

ç) Kur shfaqen pretendime nga investitorë të huaj për shkelje nga Republika e Shqipërisë të ligjit, traktateve apo marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e investimeve të huaja.

4. Këshillimi i dhënë nga Avokatura e Shtetit personave juridikë, sipas këtij neni, nuk ka karakter detyrues për to, përveç rasteve kur parashikohet si i tillë me ligj.

Neni 20
Kërkesa për këshillim

1. Personat juridikë, sipas kuptimit të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, mund t'i drejtojnë Avokaturës së Shtetit kërkesë për këshillim.

2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë marrëveshje të posaçme me Avokaturën e Shtetit, mund t'i drejtojnë Avokaturës së Shtetit kërkesë për këshillim, nëpërmjet kryetarit të tyre.

Neni 21
Procedura e këshillimit

1. Në rastet kur kërkohet këshillim, personat juridikë apo njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqesin kërkesë me shkrim, për këtë qëllim, pranë Avokaturës së Shtetit dhe vënë në dispozicion të saj:

a) të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentacionin që disponojnë për çështjen objekt këshillimi;

b) një vlerësim për rrethanat faktike dhe qëndrim të arsyetuar të çështjes;

c) të dhënat e kontaktit të një personi, për qëllime komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi me Avokaturën e Shtetit, në kuadër të çështjes objekt këshillimi.

2. Avokatura e Shtetit, gjatë ushtrimit të funksionit këshillues, mund të kërkojë plotësimin e informacionit apo të dokumentacionit të paraqitur apo mund të kërkojë informacione apo dokumente shtesë, të cilat i gjykon të nevojshme. Personat juridikë detyrohen t'i japin Avokaturës së Shtetit çdo sqarim, informacion apo dokument të kërkuar, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga depozitimi i kërkesës prej kësaj të fundit. Në këtë rast, afati për dhënien e mendimit nga Avokatura e Shtetit llogaritet nga momenti i marrjes së informacionit dhe dokumentacionit shtesë.

Për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e proçesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme të shoqërisë "Albpetrol" sh. a dhe pajisjen me çertifikatë pasurie të çdo pasurie të saj. Urdhëri nr.120 datë 05.04.2024 i administratorit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a me nr.2038 prot. datë 05.04.2024	Kryetar	Dritan Shahu
	Anëtar	Arben Beta
	Anëtar	Shpresa Pashaj
	Anëtar	Klejsi Xhaferraj
	Anëtar	Reliana Varfi
	Anëtar	Ardian Pilo
	Anëtar	Jorgjica Baba
	Anëtar	Dorian Capo

albpetrol
SHOQËRIA ALBPETROL SH.A
ADMINISTRATORI:
ELTAR DEDA
NËNSHKRIMI/VULA

Kodet për teknologjine e matjeve dhe përcaktimin e kufirit:
T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; KRGJSH; ASIG; G-GPS; S-Station Total; D-Matje; Distancash; P-Përfaq. i Pronarëve; KP-Kufitarët pjesërisht.

1. FORMULAR I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën: A.Pilo, specialist topograf, Drejtoria e Administrimit të Pronës

Institucioni Qendror Shtetëror : **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**

Supervizoi: D.Shahu, Drejtor, Drejtoria e Administrimit të Pronës
Sh.Pashaj, k/specialist, Drejtoria e Administrimit të Pronës

Aprovoi: Eltar DEDA, Administrator, Shoqëria "Albpetrol"Sh.A.

Nr. rendor	Zona Kadastrale & Indeksi i hartës	Nr. i Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e Pasurisë. Adresa	Sipërfaqja e pasurisë *(m²)*	Nga Sipërfaqja		Funksioni për të cilin përdoret prona/pasuria	Institucioni me përgjegjësi Administrative / pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë. Statusi juridik i përdorimit.	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të tjera. *(Shënime të veçanta)*
						Truall *(m²)*	Ndërtesë *(m²)*					
21	2890 K-34-112- (244-B)	15/598	Truall + Ndërtesë	Ambjentet e QEMNG Patos	4838.6	4838.6	956	Administrata e QEMNG	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Albpetrol.sha	VKM nr.219 dt.16.04.2004	Ndërtesë 1 kat
	TOTAL		**Truall + Ndërtesë**		**4838.6**	**4838.6**	**956**					

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË DATË: 05.11.2024 QËLLIMI: PËRDITËSIM/REGJISTRIM

VENDNDODHJA
BASHKIA: PATOS
TË DHËNAT E PASURISË
LLOJI I PASURISË: TRUALL

DVASHK: FIER ZONA KADASTRALE: 2890 NR.PASURISË: 15/598 INDEX HARTE: PA-E-4, PA-F-3, PA-F-4
EMËRTESA E HARTËS: K-34-112- (244-B)
SIP. PASURISË = 4856 m² SIP.GJURMËS NDËRTIMIT = m² NR.KATEVE: 1

X(N)=4505854.90 Y(E)=467094.14 **KORRNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** X(N)=4505854.90 Y(E)=467287.18



X(N)=4505726.84 Y(E)=467094.14 **SH 1:1000** X(N)=4505726.84 Y(E)=467287.18

NR	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI I KUFITARIT	KUFITARI SIPAS FAKTIT	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1	VERI		Nr. pasurisë	15/462; 15/438		
2	JUG		Nr. pasurisë	15/456		
3	LINDJE		Nr. pasurisë	15/445, 15/451, 15/77		
4	PERËNDIM		Nr. pasurisë	15/470, 15/593, 15/461		

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT:
EMRI: _____
LIÇENCA NR.____ DATË ___/___/___
KOMPANIA: _____
NIPTI: _____
NËNSHKRIMI/VULA: _____

REALIZOI PËR ASHK:
SPECIALISTI: _____
DVASHK FIER
NËNSHKRIMI: _____

KONFIRMOI:
PËRGJEGJËSI/DREJTORI: _____
NËNSHKRIMI/VULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; D-Matje Distancash.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: P-Përfaqësues i Pronarëve; SP-Strukturë e Posaçme; T-Terren; V-Vendodhje e pasurisë.
SHËNIME TË VEÇANTA:
Matjet për realizimin e planrilevimit të sipërfaqes së pasurisë 15/598 nga specialisti Topograf, u bënë në vendndodhjen e kësaj pasurie me emërtimin QEMNG (ish Ambjente e QR Mjedisit) sipas evidentimit dhe përcaktimit në terren të kufijve faktik të kësaj prone nga përfaqësuesi i QEMNG (anëtar i strukturës) dhe anëtarët e strukturës së posaçme. Ky proçes po realizohet në zbatim të VKM Nr.28 Datë 27.01.2023.

PRONARËT/BASHKËPRONARËT/DEKLARIM MBI MARRËDHËNIT ME KUFITARËT

STRUKTURA E POSAÇME		
Për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e proçesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme të shoqërisë "Albpetrol" sh. a dhe pajisjen me çertifikatë pasurie të çdo pasurie të saj. Urdhëri nr.120 datë 05.04.2024 i administratorit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a me nr.2038 prot. datë 05.04.2024	Kryetar	Dritan Shahu
	Anëtar	Dilaver Shyti
	Anëtar	Shpresa Pashaj
	Anëtar	Klejsi Xhaferraj
	Anëtar	Reliana Varfi
	Anëtar	Ardian Pilo
	Anëtar	Jorgjica Baba
	Anëtar	Dorian Capo

albpetrol
SHOQËRIA ALBPETROL SH.A
ADMINISTRATORI:
ELTAR DEDA
NËNSHKRIMI/VULA

Kodet për teknologjine e matjeve dhe përcaktimin e kufirit:
T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; KRGJSH; ASIG; G-GPS; S-Station Total; D-Matje; Distancash; P-Përfaq. i Pronarëve; KP-Kufitarët pjesërisht.

VENDIM
Nr. 717, datë 20.11.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT TË PARË TË LINJËS 110 kV BALLSH–MARINËZ DHE LINJËS BALLSH–DRENOVË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh–Marinëz dhe linjës Ballsh–Drenovë".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 24 617.22 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë njëzet e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 24 617.22 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë njëzet e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë së pasurive që shpronësohen sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION I SEGMENTIT TË PARË TË LINJËS 110 kV BALLSH–MARINËZ DHE I LINJËS BALLSH–DRENOVË"

Nr. rendor	Nr. shtylle	Pronari			Të dhëna hipotekore						Vlerësimet për shpronësim				Shënime	Adresa
											"Arë"			Vlera totale (lekë)		
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)			
		A	B	C	Ç	Ç	D	E	F	G	L	M	N	R	Y	Z
1	1	Barjam	Haki	Barjamaj	Lavdan	2388	530/5	Arë	800	800	83.34	123	10,250.82	10,250.82	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
2		Fejzo	Isuf	Çakaj	Lavdan	2388	530/6	Arë	2400	2400	5.0	123	615.00	615.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
3	2	Avdulla	Bakush	Hadaj	Lavdan	2388	110/35	Arë	1225	1225	106.4	123	13,087.20	13,087.20	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
4		Axhem	Bakush	Hadaj	Lavdan	2388	110/36	Arë	1520	1520	5.40	123	664.20	664.20	Konfirmuar nga ASHK-ja.	Fshati Lavdan, Nj. A. Qendër Dukas, Bashkia Mallakastër.
Vlera totale														24,617.22		

VENDIM
Nr. 718, datë 20.11.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 3, dhe 15, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së planifikimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 11, pas fjalës "... lulishtja ..." shtohen fjalët "... kënde lojërash për fëmijë ...".

2. Pas pikës 38 shtohen pikat 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 46, me këtë përmbajtje:

"39. "PDQ", Plani i Detajuar Qendror.

40. "PKHD", Plani Kombëtar i Hapësirës Detare.

41. "Hapësirë detare", është territori ujor i cili përbëhet nga ujërat e brendshme detare, deti territorial, zona fqinje (në vazhdim), zona ekskluzive ekonomike dhe shelfi kontinental, sipas Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

42. "Mjedis detar", është territori ujor i cili përbëhet nga vija e bregdetit shqiptar, plazhet, portet, radat e porteve dhe territoret tokësore të tyre, lagunat, grykëderdhjet e lumenjve në det, liqenet e vijës së ujit, që komunikojnë vazhdimisht ose përkohësisht me detin, ujërat e brendshme detare, territoriale dhe ekonomike.

43. "Tipologji hapësinore" është karakteri i një njësie strukturore bazuar në ndërthurjen e njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike.

44. "Parcelë minimale" është sipërfaqja minimale që duhet të ketë parcela ose një grup parcelash për t'u zhvilluar.

45. "Politika e integruar detare" (PID) është një politikë e BE-së, qëllimi i së cilës është të nxisë vendimmarrje të koordinuar dhe koherente për të maksimizuar zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen ekonomike dhe kohezionin social të shteteve anëtare dhe, veçanërisht të zonave bregdetare, ishullore dhe më të largëta në BE, si dhe të sektorëve

[1] Ky projektvendim përafron pjesërisht Direktivën 2014/89/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2024, "Për krijimin e një kuadri për planifikimin hapësinor detar". Numri CELEX 32014L0089.

detarë, përmes politikave detare dhe koherente të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë;

46. "Planifikimi hapësinor detar" është një proces me anë të të cilit analizohen dhe organizohen aktivitetet njerëzore në zonat detare për të arritur objektivat ekologjikë, ekonomikë dhe socialë.".

Neni 2

Në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 5, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Nënndarja "iii" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"iii. Planit Kombëtar të Hapësirës Detare;".

2. Pas nënndarjes "iii" shtohen nënndarjet "iv" dhe "v", me këtë përmbajtje:

"iv) Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare;

v) Planet e detajuara qendrore.".

Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "... gjatë hartimit ..." shtohen "... dhe rishikimit ...".

2. Në pikën 2, pas fjalëve "... për të cilin hartohet ..." shtohen "... apo rishikohet ...".

Neni 4

Në pikën 3, të nenit 10, bëhen këto shtesa:

1. Pas fjalëve "... gjatë zbatimit të dokumenteve të planifikimit ..." shtohen "... dhe vendimmarrjeve të KKTU-së ...".

2. Pas fjalëve "... sipas rasteve të përcaktuara ..." shtohen "... në pikën 2/1, të nenit 26, të ligjit dhe ...".

Neni 5

Pika 4, e nenit 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Procedura e thjeshtuar ndiqet:

a) kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit, për çështje të zhvillimit, të cilat duhet të marrin konfirmimin e institucioneve të fushës për garantimin e ruajtjes së vlerave natyrore e mjedisore, të trashëgimisë historike e kulturore dhe çështjeve të tjera sektoriale;

b) për integrimin e vendimeve të KKTU-së.".

Neni 6

Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 15, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Planifikimi në nivel qendror:

i. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT);

ii. Planet kombëtare sektoriale (PKS);

iii. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare (PKHD);

iv. Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare (PDZRK).

v. Planet e detyruara qendrore (PDQ).".

Neni 7

Pas seksionit 3, të kreut II, shtohet seksioni 3/1, me këtë përmbajtje:

"SEKSIONI 3/1
PLANI KOMBËTAR I HAPËSIRËS DETARE

Neni 21/1
Objekti i PKHD-së

1. Kuadri referues i PKHD-së synon promovimin e rritjes së qëndrueshme të ekonomive detare, zhvillimin e qëndrueshëm të zonave detare, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve detare dhe mban në konsideratë të veçantë ndërveprimet tokëdet dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

2. Planifikimi hapësinor detar është procesi me anë të të cilit analizohen dhe organizohen aktivitetet njerëzore në zonat detare për të arritur objektivat mjedisorë, ekologjikë, ekonomikë dhe socialë.

3. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve dhe përdorimeve përkatëse të hapësirave detare, të tashme dhe të ardhshme, të cilat përfshijnë:

a) peshkimin dhe akuakulturën;

b) zonat e peshkimit;

c) energjinë në zonat detare: kërkimin, shfrytëzimin dhe nxjerrjen e naftës, gazit dhe burimeve të tjera energjetike, mineraleve dhe agregateve, si dhe prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme;

ç) transportin detar dhe trafikun detar;

d) sigurinë kombëtare dhe stërvitjen ushtarake;

dh) natyrën, biodiversitetin, speciet dhe zonat e mbrojtura, mjedisin dhe konsideratat për ndryshimet klimatike;

e) nxjerrjen dhe shfrytëzimin e lëndës së parë;

ë) rrugët e kabllove dhe tubacioneve nënujore;
f) trashëgiminë kulturore nënujore;
g) aktivitetet e turizmit detar.

4. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare, teksa hartohet e zbatohet duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune në vazhdimësi.

Neni 21/2
Autoriteti përgjegjës për hartimin e PKHD-së

1. Procesi i hartimit të PKHD-së koordinohet nga ministria përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit e cila është edhe autoriteti kompetent për hartimin e planit, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit.

2. Pranë ministrisë përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, me urdhër të ministrit, ngrihet një grup pune me përfaqësues të institucioneve publike, me ekspertë të fushave të ndryshme me interes në hapësirat detare, vendës dhe të huaj si dhe me përfaqësues të Agjencisë. Përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit kryesojnë grupin e punës.

3. Plani i veprimeve për hartimin e PKHD-së zbatohet nga grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare hartohet nga grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në cilësinë e autoritetit kompetent, sipas parashikimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

5. Dokumenti i Planit Kombëtar të Hapësirës Detare (PKHD) i miratuar i njoftohet Komisionit Evropian.

Neni 21/3
Bashkëpunimi ndërmjet shteteve

1. Në kuadër të procesit të planifikimit dhe menaxhimit, bashkëpunohet me shtetet anëtare që kufizohen me ujëra detare, me qëllim për të garantuar që planet hapësinore detare të jenë koherente dhe të koordinuara në të gjithë rajonin detar shqiptar. Një bashkëpunim i tillë merr parasysh, në veçanti, çështjet me natyrë ndërkufitare.

2. Bashkëpunimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni realizohet nëpërmjet:
a) strukturave ekzistuese të bashkëpunimit institucional rajonal, të tilla si konventat rajonale detare;
b) rrjeteve ose strukturave të autoriteteve kompetente të shteteve anëtare;
c) çdo metode tjetër që përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

3. Autoritetet shqiptare përpiqen, kur është e mundur, të bashkëpunojnë me vendet e treta për veprimet e tyre në lidhje me planifikimin hapësinor detar në rajonet përkatëse detare dhe në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare.

Neni 21/4
Nisma për hartimin e PKHD-së

1. Procesit të punës për PKHD-në i paraprin ndërmarrja e nismës për hartimin e tij.

2. Autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen dhe hartimin e nismës është ministri përgjegjës për planifikimin e territorit, i cili e paraqet atë pranë Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për miratim.

3. Dokumenti i nismës për hartimin e PKHD-së përmban:
a) analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të dokumentit të planifikimit;
b) kufirin e hapësirës/territorit, subjekt i PKHD-së;
c) dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të ligjit, nëse ka të tilla;
ç) listën e dokumenteve përbërëse të PKHD-së;
d) të dhëna për ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PKHD-në;
dh) përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit e të takimeve publike dhe për afatet përkatëse;
e) planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PKHD-së;
ë) të dhëna për buxhetin për hartimin e PKHD-së;
f) sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë ose një pjesë të territorit, sipas nenit 33 të ligjit, të shoqëruar me hartën përkatëse.

4. Nisma duhet të bëhet publike dhe të botohet në regjistër nga autoriteti përgjegjës, si më poshtë vijon:

a) Vendimi i autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror për marrjen e nismës botohet në regjistër, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas pikave 1 dhe 4, të nenit 56 të ligjit;

b) Vendimi i autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror për marrjen e nismës botohet edhe në faqen zyrtare të tij.

5. Hyrja në fuqi e vendimit të KKTU-së për miratimin e nismës bëhet pasi ky vendim së bashku me dokumentin e nismës:

a) botohen në regjistër nga sekretariati i KKTU-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit, sipas pikave 1 dhe 4, të nenit 56 të ligjit.

b) botohen edhe në faqen zyrtare të sekretariatit të KKTU-së, autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror dhe Agjencisë.

Neni 21/5

Përmbajtja e dokumentit të PKHD-së

Dokumenti i PKHD-së përmban të paktën:

1. Analizën e hapësirës detare dhe territorit që e ndikon, e cila përmban:

a) analizën e përgjithshme për përcaktimin e statusit aktual dhe të ardhshëm të hapësirës detare, duke evidentuar dhe përshkruar në mënyrë të detajuar elementet apo sektorët që përfshihen në PKHD;

b) databazën e të dhënave të nevojshme për hartimin e PKHD-së, që përfshin:

i. kushtet fizike dhe mjedisore: të dhëna oqeanografike dhe karakteristika të tjera fizike e mjedisore (batimetria, rrymat, sedimentet), shpërndarjet biologjike dhe ekologjike, duke përfshirë zona me rëndësi të njohur për një specie ose komunitet biologjik të caktuar, cilësinë e ujërave dhe parametrat ekologjikë e biologjikë;

ii. aktivitetin njerëzor ekonomik dhe social.

c) analizën e ndërveprimit tokë-det, në aspektet e aktivitetit njerëzor ekonomik e social, të mjedisit, të natyrës, ndryshimeve klimatike dhe sigurisë. Kjo analizë duhet të marrë parasysh gjendjen ekzistuese në territor dhe hapësirën detare, si dhe propozimet e dokumenteve të tjera të planifikimit në fuqi për të ardhmen.

2. Analizën e dokumenteve të planifikimit të shteteve fqinje për zonat ndërkufitare.

3. Kuadrin ligjor, si dhe politikat dhe strategjitë kombëtare e ndërkombëtare ku bazohet plani.

4. Vizionin dhe objektivat strategjikë të zhvillimit dhe përdorimit të hapësirës detare dhe mjedisit detar.

5. Planin e veprimeve, të projekteve dhe të investimeve strategjike për zbatimin e PKHD-së.

6. Përcaktimin e saktë në planifikim të përdorimit dhe ndërveprimit të hapësirave detare, mjedisit detar dhe territoreve tokësore të lidhura me detin, të cilat mund të përfshijnë:

a) zonat e akuakulturës;

b) zonat e peshkimit;

c) instalimet dhe infrastrukturat për kërkimin, shfrytëzimin dhe nxjerrjen e hidrokarbureve të lëngshme, gazit dhe burimeve të tjera të energjisë, të mineraleve dhe agregateve, si dhe për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme;

ç) rrugët e transportit detar dhe flukset e trafikut;

d) zonat e stërvitjes ushtarake;

dh) vendet për ruajtjen e natyrës e specieve dhe zonat e mbrojtura;

e) zonat e nxjerrjes së lëndëve të para;

ë) kërkimin shkencor;

f) trajektoret e kabllove dhe tubacioneve nënujore;

g) turizmin;

gj) trashëgiminë kulturore nënujore etj.

7. Përcaktimet e procesit të harmonizimit të planeve ekzistuese me PKHD-në.

8. Përcaktimin e masave mbrojtëse në zbatim të legjislacionit sektorial, për:

a) interesat dhe aktivitetet detare;

b) burimet natyrore;

c) zonat e trashëgimisë kulturore nënujore;

ç) ndotjen detare;

d) aktivitetet e nxjerrjes së mineraleve në det të hapur;

dh) fatkeqësitë natyrore.

9. Studimin e vlerësimit strategjik mjedisor, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis të planit.

10. Metodologjinë dhe treguesit për monitorimin e zbatimit të PKHD-së dhe afatet për rishikimin e tij.

11. Hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e PKHD-së.

12. Relacionin e propozimeve për investime strategjike dhe projekte pilote të zhvillimit.

Neni 21/6
Miratimi dhe hyrja në fuqi e PKHD-së

1. Procesi i miratimit të Planit Kombëtar të Hapësirës detare (PKHD) bëhet, në përputhje me përcaktimet e nenit 25 të ligjit.

2. Procesi i miratimit të planit përmban, të paktën, këta hapa:

a) paraqitjen e kërkesës së autoritetit përgjegjës për miratimin e planit;

b) vendimmarrjen e KKTU-së;

c) vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave.

3. Materialet që dorëzohen/botohen për miratimin e dokumentit të planifikimit janë:

a) nisma e miratuar në KKTU;

b) dokumenti i plotë i PKHD-së;

c) deklarata Mjedisore për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, referuar legjislacionit të posaçëm në fuqi.

4. Pas botimit në regjistër të dokumentit të plotë të PKHD-së, autoriteti përgjegjës bën kërkesën për miratimin e planit në KKTU.

5. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare (PKHD) miratohet nga KKTU-ja, në përputhje me nenin 25 të ligjit.

6. Vendimi i KKTU-së botohet në regjistër dhe në çdo rast edhe në faqen zyrtare të sekretariatit të KKTU-së, autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror dhe agjencisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 25 të ligjit.

7. Pas botimit në regjistër të vendimit të KKTU-së dhe dokumenteve shoqëruese të tij, autoriteti kombëtar i planifikimit të territorit bën kërkesë për miratimin e planit në Këshillin e Ministrave.

8. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare (PKHD) miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të ligjit.

9. Plani Kombëtar i Hapësirës Detare (PKHD) hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe botimit të plotë të dokumenteve të tij në Fletoren Zyrtare.

10. PKHD-ja rishikohet kur është e nevojshme, sipas nenit 26, të ligjit, por të paktën çdo dhjetë vjet.

Neni 21/7
Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PKHD-së

1. Monitorimi i zbatimit të PKHD-së bëhet nga autoritetet përgjegjëse në procesin e hartimit të planit, në përputhje me shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 8, dhe shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit, si dhe nga agjencia, në përputhje me pikën 2, të nenit 10, të kësaj rregulloreje.

2. Monitorimi i zbatimit të planit bëhet mbi bazën e planit të veprimeve dhe dokumentit të indikatorëve të monitorimit, të miratuar si pjesë përbërëse e dokumentit të planit.".

Neni 8

Në nenin 34 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Në rast se PDZRK-ja hartohet me nismë publike, koordinimi dhe hartimi realizohen nëpërmjet një grupi pune ndërinstitucional, bazuar në urdhrin e ministrit të linjës për zonën/çështjen e rëndësisë kombëtare ose bazuar në urdhrin e autoritetit përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror, në rastet e përfshirjes së disa sektorëve ose nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit me kërkesë të ministrisë së linjës për zonën/çështjen e rëndësisë kombëtare.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

"3.1 Në rast se PDZRK-ja hartohet me nismë private, koordinimi realizohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit pas njoftimit të ministrisë së linjës për zonën/çështjen e rëndësisë kombëtare.".

Neni 9

Në nenin 35 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Hartimi i PDZRK-së nis pas njoftimit të dokumentit të nismës së hartuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit te ministri përgjegjës për çështjen/zonën e rëndësisë kombëtare dhe botimit të dokumentit në regjistër.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1. Plani i Detajuar për një Zonë të Rëndësisë Kombëtare (PDZRK), i iniciuar me nismë private, hartohet nga projektuesi i licencuar, i cili është i kontraktuar nga subjekti privat.".

3. Në pikën 3, pas fjalëve "... autoriteti përgjegjës ..." shtohen "... /projektuesi i licencuar ...".

4. Në pikën 5, fjalët "... Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit." zëvendësohen me "... sistemit *e-Planifikimi* ose mjeteve tradicionale të informimit.".

Neni 10

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen e nismës, sipas pikës 2, të nenit 18, të ligjit, është ministri përgjegjës për zonën/çështjen përkatëse të rëndësisë kombëtare ose autoriteti përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror, në rastet e përfshirjes së disa sektorëve, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit pas kërkesës së ministrisë ose palët e interesuara që kanë në pronësi jo më pak se 51% të sipërfaqes së territorit të PDZRK-së, në rastet kur hartimi i PDZRK-së kërkohet në Planin e Përgjithshëm Vendor.".

b) Shkronja "b" shfuqizohet.

2. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Në rast se PDZRK-ja hartohet me nismë private, dokumenti hartohet nga subjekti i licencuar dhe i autorizuar nga palët e interesuara që kanë në pronësi jo më pak se 51% të sipërfaqes së territorit të PDZRK-së dhe që duhet të plotësojë deklaratën e përgjegjësisë profesionale.".

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Dokumenti i nismës i njoftohet ministrit përgjegjës për zonën/çështjen përkatëse të rëndësisë kombëtare dhe KKTU-së. Dokumenti duhet të bëhet publik dhe të botohet në regjistër dhe në faqen zyrtare nga autoriteti përgjegjës.".

4. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 11

Në nenin 39 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "a", të pikës 2, pas fjalës " ... Agjencia;" shtohen fjalët "... në rastet kur dokumenti i PDZRK-së nuk hartohet prej saj;".

2. Shkronja "a", e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Dokumenti i nismës;".

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Pas botimit në regjistër të dokumenteve të plota të PDZRK-së, sipas përcaktimeve të dokumentit të nismës, autoriteti përgjegjës ose subjekti i interesuar, nëpërmjet projektuesit të licencuar, në rast se PDZRK- ja është me nismë private, bën kërkesën për marrjen e aktit të përputhshmërisë së dokumentit nga Agjencia.".

4. Shkronja "a", e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Pas botimit në regjistër të raportit të vlerësimit teknik të PDZRK-së, Agjencia, autoriteti përgjegjës ose projektuesi i licencuar duhet të rishikojë/të përmirësojë dokumentin e planit për të pasqyruar vërejtjet dhe sugjerimet, nëse ka të tilla.".

Neni 12

Pas seksionit 5, të kreut II, shtohet seksioni 5/1, me këtë përmbajtje:

"SEKSIONI 5/1
PLANI I DETAJUAR QENDROR

Neni 41/1
Objekti dhe qëllimi i PDQ-së

1. Plani i Detajuar Qendror është studim hapësinor territorial për një territor të caktuar në përgjegjësi të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, me ndikim dhe interes të veçantë për zhvillime me rëndësi kombëtare apo strategjike.

2. PDQ-ja trajton territore të cilat kanë nevojë për studime dhe planifikime më të zgjeruara, kur nevojitet menaxhimi i integruar i disa zhvillimeve në territor, në funksion të një vizioni të përbashkët zhvillimi.

3. Plani i Detajuar Qendror ka për qëllim krijimin e bazave për zhvillimin e kontrolluar të territorit për të cilin hartohet, si krijimin e bazave për zhvillimin e vendbanimeve, infrastrukturës, turizmit, industrisë etj.

4. Për territorin, subjekt të tij, PDQ-ja ka për qëllim:

a) zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e territorit;

b) rigjenerimin/ripërtëritjen urbane apo natyrore;

c) përcaktimin e përdorimit të tokës, infrastrukturave, kushteve të zhvillimit dhe rregullave të nevojshme për zhvillim/rizhvillim.

5. Struktura, forma, si dhe procesi për hartimin dhe miratimin e PDQ-së përcaktohen në këtë rregullore, ndërsa zbatimi i PDQ-së përcaktohet

nëpërmjet instrumenteve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit të detajuara në rregulloren e zhvillimit që jepet nga KKTU-ja mbi bazën e këtij dokumenti planifikimi.

6. PDQ-ja teksa hartohet e zbatohet, duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune në vazhdimësi.

7. Parashikimet e PDQ-së pasqyrohen automatikisht në dokumentet e tjera të planifikimit, sipas parimit të hierarkisë dhe parashikimet e tij integrohen automatikisht në PDZRK-të në fuqi.

Neni 41/2
Autoriteti përgjegjës për PDQ-në

1. Plani i Detajuar Qendror fillon të hartohet pas njoftimit të KKTU-së, nisur nga interesi publik për pajisje me infrastrukturë, shërbime e facilitete publike dhe menaxhimi i integruar i disa zhvillimeve në territor, në funksion të një vizioni të përbashkët zhvillimi, për të cilin mund të shprehen me kërkesë edhe palët e interesuara për zhvillim.

2. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit harton PDQ-në në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjen/sektorin përkatës, sekretariatin teknik të KKTU-së, apo institucione të tjera qendrore, kompetente për çështjen/zonën.

3. Plani i Detajuar Qendror hartohet nga grupe pune të kryesuara nga Agjencia, me specialistë të institucioneve publike, me ekspertë të fushave të ndryshme, vendës apo edhe të huaj.

4. Në rast hartimi nga grupe pune me ekspertë të jashtëm, procesi mbikëqyret në çdo hap nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Neni 41/3
Hartimi, këshillimi dhe bashkërendimi i PDQ-së

1. Fillimisht KKTU-ja njoftohet për nisjen e hartimit e PDQ-së.

2. Njoftimi për nisjen e hartimit të PDQ-së përmban:

a) kufijtë e territorit për të cilin do të hartohet PDQ-ja;

b) kalendarin e aktiviteteve për hartimin e PDQ-së;

c) profilet e ekspertizës së grupit të punës.

3. PDQ-ja hartohet në zbatim të parimeve kombëtare të planifikimit dhe të zhvillimit, ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

4. Bashkërendimi dhe këshillimi i PDQ-së është përgjegjësi e Agjencisë dhe kryhet përmes botimit të dokumentit në regjistër dhe informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe, në rast se kërkohet, përmes organizimit të takimeve publike me ta.

5. Dokumentet e PDQ-së këshillohen dhe bashkërendohen me të gjitha institucionet në nivel qendror e vendor, të cilat preken nga zhvillimi i territorit të zonës së përcaktuar për hartimin e PDQ-së ose pjesë të saj nëpërmjet Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit në nivel qendror (FBPQ), sipas përcaktimeve të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

6. Në çdo rast, autoritetet vendore përkatëse të planifikimit dhe zhvillimit njoftohen për nisjen e procesit të hartimit të PDQ-së, për të marrë masa për respektimin e pezullimit së zhvillimit.

Neni 41/4
Përmbajtja e PDQ-së

1. Dokumenti i Planit të Detajuar Qendror hartohet në përputhje me dokumentet e planifikimit qendror dhe legjislacionin në fuqi, duke marrë në konsideratë dokumente të planifikimit vendor sektorial, në rast se ka.

2. Plani i Detajuar Qendror përmban të paktën:

a) Planin e detajuar të zhvillimit, i shprehur në relacion dhe harta shoqëruese për pikat e mëposhtme:

i. analizën që paraprin përcaktimet territoriale;

ii. përcaktimin e njësive strukturore, në përputhje me nenin 77 të kësaj rregulloreje;

iii. përcaktimet për përdorimin e tokës për çdo njësi në kategori, nënkategori dhe funksione sipas kësaj rregulloreje;

iv. përcaktimet e infrastrukturave teknike, duke përfshirë ato të transportit, energjisë, telekomunikacionit dhe ujësjellës-kanalizimeve;

v. përcaktimet e kushteve të zhvillimit për njësitë, sipas rastit dhe/ose për parcelat;

vi. përcaktimet për zonat/objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi, sipas rastit;

vii. programet e përdorimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, bazuar në nenet 30–36 të ligjit, sipas rastit;

viii. planin për zbatimin e PDQ-së për ndërtimin e infrastrukturave dhe shërbimeve publike, sipas rastit.

b) Rregulloren e planit të detajuar, ku përfshihen:

i. përkufizimet e termave të përdorur;

ii. shpjegimi i kodeve të përdorura;

iii. rregullat, të dhënat dhe kushtet e zhvillimit për çdo njësi, sipas shtojcës II në fund të kësaj rregulloreje;

iv. rregulla për ndarjen dhe bashkimin e parcelave, sipas rastit;

v. rregulla për zbatimin e instrumenteve për drejtimin e zhvillimit sipas neneve 30–36 të ligjit, sipas rastit;

vi. kushtet dhe rregullat teknike për zbatimin e infrastrukturave;

vii. rregullat për distancat, përcaktimi i vijës së kuqe dhe, sipas rastit, vijës blu;

viii. rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit;

ix. rregullat e ruajtjes së zonave, objekteve të trashëgimisë kulturore, sipas rastit;

x. rregulla arkitektonike dhe estetike;

xi. rregulla për përshtatjen e hapësirave për personat me aftësi të kufizuara;

xii. informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS;

xiii. Raportin se si parashikimet e dokumentit ndikojnë në mjedis.

Neni 41/5
Miratimi dhe hyrja në fuqi e PDQ-së

1. Autoriteti përgjegjës për miratimin e PDQ-së është Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.

2. Procesi i miratimit të PDQ-së bëhet në përputhje me përcaktimet e neneve 18/1 dhe 25 të ligjit.

3. Vendimi i KKTU-së së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues botohet në regjistër dhe, në çdo rast, në faqen zyrtare të sekretariatit të KKTU-së dhe autoritetit përgjegjës për planifikimin, brenda 15 ditëve nga data e konfirmimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 25 të ligjit.

4. Dokumenti i PDQ-së dhe pjesët përbërëse të tij, subjekt miratimi, hyjnë në fuqi me botimin e plotë në regjistër të vendimit të KKTU-së dhe dokumenteve shoqëruese të tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 56 të ligjit.

5. Me hyrjen në fuqi të PDQ-së, njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa që dokumenti i PDQ-së të integrohet me planin e përgjithshëm vendor, duke ndjekur përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Neni 41/6
Zbatimi i PDQ-së

1. Plani i Detajuar Qendror zbatohet nëpërmjet lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, në zbatim të rregullores së tij.

2. Plani i Detajuar Qendror regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme, si dhe shërben për ndarjen apo bashkimin e pasurive ekzistuese, si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nënndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksioni, me kërkesë të zhvilluesit.

3. Lejet e ndërtimit, për ndërtime brenda zonës, për të cilën është hartuar PDQ-ja, jepen mbi bazën e këtij plani nga autoriteti përgjegjës, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe i Ujit apo autoriteti vendor në rast delegimi kompetencash, në përputhje me shkronjën "a", të nenit 29, të ligjit, dhe përcaktimeve të rregullores së zhvillimit, në zbatim të ligjit.".

Neni 13

Në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 68, fjala "... njësie ..." zëvendësohet me fjalët "... apo disa njësive ...".

Neni 14

Në nenin 70 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët "... Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit ..." zëvendësohen me "... sistemin *e-Planifikimi* ...".

2. Në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2, pas fjalës "... njësisë ..." shtohen fjalët "... ose grup-njësive ...".

3. Në pikat 3 dhe 4, fjala "... regjistër ..." zëvendësohet me "... sistem ...".

Neni 15

Në nenin 71 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht përcaktimeve në dokumentet e planifikimit në fuqi, PDV-ja mund të riorganizojë infrastrukturën rrugore lokale të parashikuar, në rast se konsiderohet e nevojshme për të rritur eficiencën dhe cilësinë e aksesit dhe të hapësirave urbane, si edhe pa cenuar aksesueshmërinë publike të zonës referuar një projekti teknik, i cili siguron ndërlidhjen ndërmjet rrugëve më të afërta.".

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Rregullorja e dokumenti të planit të detajuar vendor duhet të përcaktojë shpërndarjen e balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.".

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Vendimet e KKTU-së pasqyrohen në dokumentin e PDV-së gjatë hartimit ose rishikimit të saj. Pavarësisht treguesve të zhvillimit, të miratuar me rregullore të veçantë nga KKTU-ja, treguesit e zhvillimit të përcaktuar nga PPV-ja do të shpërndahen nga PDV-ja në mënyrë proporcionale në të gjitha pjesët e territorit të njësisë ku ndërhyhet nëpërmjet rizhvillimit.".

Neni 16

Në nenin 72 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, shkurtesa "... RKPT-së ..." zëvendësohet me "... sistemit *e-Planifikimi* ...".

2. Në pikën 7, fjalët "... Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit ..." zëvendësohen me "... sistemin *e-Planifikimi* ...".

Neni 17

Kudo në tekstin e rregullores, fjalët "Këshilli Kombëtar i Territorit//KKT" zëvendësohen përkatësisht me "Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit/KKTU".

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 719, datë 20.11.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË UZBEKISTANIT, PËR PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË KËRKESAVE PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Uzbekistanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË UZBEKISTANIT PËR PËRJASHTIMIN E NDËRSJELLË TË KËRKESAVE PËR VIZA PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Uzbekistanit, në vijim të referuara si "Palë",

të udhëhequr nga dëshira për të forcuar marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Uzbekistanit,

në përputhje me parimet e barazisë dhe reciprocitetit,

me dëshirën për të thjeshtuar kushtet e udhëtimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Uzbekistanit, të cilët janë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të shtetit të njërës Palë do të hyjnë, dalin, kalojnë transit dhe qëndrojnë përkohësisht në territorin e shtetit të Palës tjetër pa viza për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda çdo periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e hyrjes në territorin e shtetit të asaj Pale, me kusht që të mos kryejnë aktivitet me pagesë në shtetin pritës.

2. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të shtetit të njërës Palë, të cilët synojnë të hyjnë në territorin e shtetit të Palës tjetër për një periudhë më të gjatë se periudha e parashikuar në paragrafin 1, të këtij neni, do të marrin një vizë për të hyrë në territorin e shtetit të kësaj Pale.

3. Kohëzgjatja e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të shtetasve të njërës nga Palët do të jetë e vlefshme të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së synuar të nisjes nga territori i shtetit të Palës tjetër.

Neni 2

1. Në rast se secila Palë emëron ndonjë nga shtetasit e saj me pasaportë të vlefshme diplomatike dhe shërbimi në misionet e saj diplomatike dhe postet konsullore ose organizatat ndërkombëtare në territorin e shtetit të Palës tjetër, ajo do të njoftojë Palën tjetër për këtë emërim pas mbërritjes së të emëruarit në territorin e shtetit të Palës tjetër.

2. Pas mbërritjes në territorin e shtetit të Palës tjetër, personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të akreditohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve me kërkesë të misionit përkatës diplomatik dhe posteve konsullore ose organizatave ndërkombëtare dhe në përputhje me ligjet e shtetit të Palës pritëse.

3. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të njërës nga Palët, të cilët janë caktuar anëtare në misionet diplomatike ose postet konsullore ose përfaqësues të organizatave ndërkombëtarë të vendosura në territorin e shtetit të Palës tjetër, do t'u kërkohet të marrin vizë të përshtatshme përpara hyrjes së tyre në territorin e shtetit pritës, për akreditim.

4. Kushtet e parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni zbatohen edhe për bashkëshortin, fëmijët e mitur dhe prindërit në ngarkim të zyrtarit të misionit diplomatik, postit konsullor ose organizatës ndërkombëtare, të akredituar në territorin e shtetit të Palës tjetër, me kusht që të jenë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të shtetit të Palës tjetër.

Neni 3

1. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të shtetit të secilës Palë, në rast të humbjes ose dëmtimit të pasaportave në territorin e Shtetit të Palës tjetër, do të informojnë menjëherë misionin diplomatik ose postin konsullor të shtetit të vet, i cili do të njoftojë autoritetet përkatëse të shtetit pritës për të marrë masat e duhura.

2. Në këmbim të dokumentit të humbur ose të dëmtuar, misioni diplomatik ose posti konsullor i shtetit të Palës në fjalë do të lëshojë një pasaportë të re diplomatike ose shërbimi ose një dokument tjetër udhëtimi, duke zëvendësuar përkohësisht pasaportën e humbur.

Neni 4

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të njërës Palë do të kalojnë kufirin e shtetit të Palës tjetër vetëm përmes pikave kufitare të hapura për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve në përputhje me legjislacionin e shtetit të asaj Pale.

Neni 5

Autoritetet kompetente të shtetit të njërës Palë rezervojnë të drejtën të refuzojnë mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të shtetit të Palës tjetër, praninë e të cilëve ata e gjykojnë të padëshirueshme, të hyjnë ose të shkurtojnë qëndrimin e tyre në territorin e atij shteti.

Neni 6

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të shtetit të njërës Palë gjatë qëndrimit të tyre në territorin e shtetit të Palës tjetër janë të detyruar të respektojnë legjislacionin e atij shteti.

Neni 7

1. Secila Palë, pa dhënë asnjë arsye, rezervon të drejtën të refuzojë hyrjen në territorin e shtetit të saj ose të kufizojë periudhën e qëndrimit të mbajtësve të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit të shtetit të Palës tjetër.

2. Secila Palë, në rast nevoje, për të garantuar rendin publik, mbrojtjen e sigurisë shtetërore ose shëndetin publik, mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast, Pala tjetër do të njoftohet menjëherë për një vendim të tillë me shkrim.

3. Pala që ka vendosur të zbatojë masat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni do të njoftojë menjëherë me shkrim Palën tjetër për anulimin e masave të treguara dhe rifillimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Palë do të shkëmbejnë përmes kanaleve diplomatike ekzemplaret e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, si dhe një përshkrim të detajuar të këtyre dokumenteve jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse brenda vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje autoritetet kompetente të shteteve të Palëve ndryshojnë pasaportat diplomatike ose të shërbimit ose bëjnë ndryshime në to, kjo Palë do të njoftojë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, Palën tjetër jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në fjalë dhe njëkohësisht t'u transmetojë autoriteteve kompetente të shtetit të Palës tjetër ekzemplarët e pasaportave të reja, si dhe përshkrimin e detajuar të tyre.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve, që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 10

Sipas marrëveshjes reciproke, Palët mund të bëjnë ndryshime ose modifikime në Marrëveshje duke regjistruar protokolle të veçanta, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e saj. Ajo do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim përmes kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme shtetërore nga Palët, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje me dërgimin e njoftimit me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë pas 30 (tridhjetë) ditësh nga data kur Pala tjetër merr njoftimin e denoncimit.

Bërë në Nju-Jork, më 22.9.2024, në dublikatë, secila në gjuhën shqipe, uzbeke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË UZBEKISTANIT

VENDIM
Nr. 720, datë 20.11.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË KIRGIZSTANIT, PËR PËRJASHTIMIN E KËRKESAVE PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

18.1.2	Studimi i vizibilitetit për hapjen e zyrave të reja Policore urbane dhe ato rurale.	Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	Policia e Shtetit	Donatorë	2024	2026	10,247,740	0	10,247,740	10,247,740	0	10,247,740	10,247,740	0	10,247,740	30,743,220	0	30,743,220	30,743,220	0	30,743,220	0	0		0	0
	Masa 19 : Motivimi i punonjësve të policisë të zonës policore.																									0
19.1.1	Promovimi i vlerave pozitive, nëpërmjet dhënies së stimujve moral dhe material për Ndihmës Specialistët /SPZ.	Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140 Kodi i produktit 91604AA	Policia e Shtetit	NJVV; aktorët e tjerë	2024	2026	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	10,500,000	0	10,500,000	10,500,000	0	10,500,000	0	0		0	0
19.1.2	Hartimi i një studimi mbi kënaqësinë e punonjësve të policisë në punë dhe metodat e motivimit të tyre.	Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140 Kodi i produktit 91604AA	Policia e Shtetit	Donatorë; projekte OJF të ndryshme	2024	2026	1,129,640	0	1,129,640	1,129,640	0	1,129,640	1,129,640	0	1,129,640	3,388,920	0	3,388,920	3,388,920	0	3,388,920	0	0		0	0
	Kostoja e objektivit specifik 3.2						**14,877,380**	**69,698,772**	**84,576,152**	**14,877,380**	**69,698,772**	**84,576,152**	**14,877,380**	**69,698,772**	**84,576,152**	**44,632,140**	**209,096,316**	**253,728,456**	**44,632,140**	**0**	**44,632,140**	**0**	**209,096,316**	**0**	**209,096,316**	**0**
	Kostoja totale e qëllimit të politikës III (objektivi specifik 3.1+3.2)						**100,604,537**	**69,698,772**	**170,303,289**	**110,985,199**	**69,698,772**	**180,683,971**	**109,777,435**	**69,698,772**	**179,476,187**	**321,367,132**	**209,096,316**	**530,463,448**	**321,367,132**	**0**	**321,367,132**	**0**	**209,096,316**	**0**	**209,096,316**	**0**
	Kostoja totale e Planit të Veprimit = Politika 1 + Politika 2 + Politika 3						**4,559,937,813**	**83,264,125**	**4,643,201,938**	**4,638,663,947**	**82,962,558**	**4,721,626,802**	**4,638,853,003**	**82,380,974**	**4,721,733,977**	**13,834,409,045**	**249,307,955**	**14,083,516,999**	**13,834,409,045**	**25,011,639**	**13,859,420,683**	**0**	**209,096,316**	**0**	**209,096,316**	**15,000,000**

Qëllimi i politikës I :Rritja e parametrave të sigurisë

Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative			Burimi i mbulimit deri në 2026						Hendeku financiar 2024–2026 (në lekë)	Kostoja totale ne EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 100ALL)
								PBA			Financimi i huaj				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total kosto	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH		
Objektivi specifik 1.1 Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin	DPPSH	KVSP; bashkitë; Institucioni i Prefektit institucionet shtetërore; Shoqëria civile; Komuniteti Programi SCPA; Shoqëria civile; OJF	**2021**	**2023**	1,774,330,219	0	**1,774,330,219**	1,774,330,219	0	**1,774,330,219**	0	0	**0**	**0**	**17,743,302**
Objektivi specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet	DPPSH; ASCAP	KVSP; NJVV; institucionet e tjera të linjës; SCPA:DPAP; MASR; SHSSH; ASHMDF; ISHP; NJVKSH; DRSHSSH	**2021**	**2023**	2,469,400,635	489,802	**2,469,890,437**	2,469,400,635	489,802	**2,469,890,437**	0	0	**0**	**0**	**24,698,904**
Objektivi specifik 1.3 Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit	NJVV; AMVV; DPPSH/DVP; MSHMS	NJVV; MKR OSHC-të e specializuara; donatorët (SCPA); institucionet shtetërore në nivel vendor; DPPSH-DVP	**2021**	**2023**	8,096,357,226	16,163,731	**8,112,520,958**	8,096,357,226	1,163,731	**8,097,520,958**	0	0	**0**	**15,000,000**	**81,125,210**
Kostoja totale e qëllimit të politikës I (objektivi specifik 1.1+1.2+13)					**12,340,088,079**	**16,653,534**	**12,356,741,613**	**12,340,088,079**	**1,653,534**	**12,341,741,613**	**0**	**0**	**0**	**15,000,000**	**113,364,602**

Qëllimi i politikës II : Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin

Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Hendeku financiar 2024–2026 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 100ALL)
								PBA			Financimi i huaj				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH		
Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i komunikimit me publikun	DPPSH-DVP; MSHMS; MB; NJVV	ASCAP/MASR; ministritë e linjës; NJVV; KVSP; MKR OSHC e specializuara; donatorët; MB/PSH; Akademia e Sigurisë;	**2021**	**2026**	679,713,990	23,358,105	**703,072,095**	679,713,990	23,358,105	**703,072,095**	0	0	**0**	**0**	**7,030,721**
Objektivi specifik 2.2: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve	MSHMS; MB; AMVV; NJVV	Institucionet anëtare të KVSP;MKR/NJMF; OSHC-të e specializuara; Donatorët; Ministritë e linjës; Komunitetet fetare; Shoqëria civile; Media; Biznesi	**2021**	**2026**	486,639,844	0	**486,639,844**	486,639,844	0	**486,639,844**	0	0	**0**	**0**	**4,866,398**
Objektivi specifik 2.3: Rritja e mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Sigurinë Publike	NJVV - KVSP;AMVV: MB	NJVV/AMVV	**2021**	**2026**	6,600,000	0	**6,600,000**	6,600,000	0	**6,600,000**	0	0	**0**	**0**	**66,000**
Kostoja totale qëllimit të politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)					**1,172,953,834**	**23,358,105**	**1,196,311,939**	**1,172,953,834**	**23,358,105**	**1,196,311,939**	**0**	**0**	**0**	**0**	**10,975,339**

Qëllimi i politikës III: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet

Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Hendeku financiar 2024–2026 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 100ALL)
								PBA			Financimi i huaj				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total kosto	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH		
Objektivi specifik 3.1 Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet	DPPSH;MB	Akademia e Sigurisë; Programi SCPA; MASR; NJVV - KVSP	**2020**	**2030**	276,734,992	0	**276,734,992**	276,734,992	0	**276,734,992**	0	0	**0**	**0**	**2,767,350**
Objektivi specifik 3.2 Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë	DPPSH - DVP; MB; Programi SCPA (donatorë)	NJVV/njësitë administrative institucionet e tjera; donatorët	**2020**	**2030**	44,632,140	209,096,316	**253,728,456**	44,632,140	0	**44,632,140**	0	209,096,316	**209,096,316**	**0**	**2,537,285**
Kostoja totale e qëllimit të politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2)					**321,367,132**	**209,096,316**	**530,463,448**	**321,367,132**	**0**	**321,367,132**	**0**	**209,096,316**	**209,096,316**	**0**	**5,304,634**
Kostoja totale e planit të veprimit					**13,834,409,045**	**249,107,955**	**14,083,516,999**	**13,834,409,045**	**25,011,639**	**13,859,420,683**	**0**	**209,096,316**	**209,096,316**	**15,000,000**	**129,644,575**

Kostoja totale e Planit të Veprimit	14,083,516,999
PBA 2024–2026	13,859,420,683
Financimi i huaj	209,096,316
Hendeku financiar 2024–2026	15,000,000

	Kostoja korente	Kostoja kapitale	Totali
Qëllimi i politikës I	12,340,088,079	16,653,534	12,356,741,613
Qëllimi i politikës II	1,172,953,834	23,358,105	1,196,311,939
Qëllimi i politikës III	321,367,132	209,096,316	530,463,448

Kostoja korente	13,834,409,045
Kostoja kapitale	249,107,955
Total kosto	14,083,516,999

Nevojat kapitale (në lek)

Qëllimet e politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kostoja totale 2024–2026	Kosto e planifikuar në PBA 2024–2026 Buxheti dhe Donatorët	Hendeku financiar 2024–2026
QP1: Rritja e parametrave të sigurisë	Korente	12,340,088,079	12,340,088,079	**15,000,000**
	Kapitale	16,653,534	1,653,534	
QP2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin	Korente	1,172,953,834	1,172,953,834	**0**
	Kapitale	23,358,105	23,358,105	
QP3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet	Korente	321,367,132	321,367,132	**0**
	Kapitale	209,096,316	209,096,316	
TOTALI [lekë]		**14,083,516,999**	**14,068,516,999**	**15,000,000**
TOTALI [euro] ***1 euro 100 Leke***		**140,835,170**	**140,685,170**	**150,000**




NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË PLANIT TË VEPRIMIT
Kosto kapitale
2%
Kosto Korente
98%


Kostot lidhur me Qëllimet e Politikave
100%
90%
80%
70%
60%
50%
40%
30%
20%
10%
0%
16,653,534
12,340,088,079
23,358,...
1,172,953,834
209,096,316
321,367,132
Kosto Kapitale
Kosto Korente
Qëllimi i Politikës I
Qëllimi i Politikës II
Qëllimi i Politikës III

VENDIM
Nr. 723, datë 20.11.2024

PËR AUTORIZIMIN E KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE, PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË IDENTIFIKIMIT TË PRONËS SHTETËRORE ME INTERES PËR TË REALIZUAR PROJEKTE INVESTIMI NË FSHATIN VRINË, BASHKIA KONISPOL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, në përputhje me objektivat e saj, me qëllim identifikimin e pronës shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi në fshatin Vrinë, Bashkia Konispol, ngarkohet për përmbushjen e detyrave, si më poshtë vijon:

a) Të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet procedurale për konsolidimin e pronës shtetërore në këtë zonë/njësi territoriale, si më poshtë vijon:

i. në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës koordinimin dhe bashkërendimin me institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të përfshira në çështjet e pronësisë apo administrimit të këtyre pronave, për dhënien dhe shkëmbimin e informacionit apo të dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me të drejtat e pronësisë, që është i nevojshëm për një pasqyrim të gjendjes së pronësisë, caktimin më të saktë të kufijve të zonës dhe përfundimin me prioritet të procesit të regjistrimit të pronës në regjistrat e pasurive të paluajtshme;

ii. negocimin me subjektet private, të përfshira në marrëdhënien juridike të pronësisë për këto prona, në lidhje me sqarimin dhe qartësimin e statusit të pjesës përkatëse të pronës shtetërore në këtë zonë;

b) Të hartojë dhe të sigurojë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, një masterplan të zhvillimit të zonës, në të cilën ndodhet prona shtetërore. Shpenzimet për realizimin e këtij masterplani mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare;

c) Të hartojë dhe të paraqesë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, një projekt zhvillimi të pronës shtetërore në këtë zonë. Shpenzimet për realizimin e këtij projektzhvillimi mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

2. Institucionet shtetërore të përfshira në çështjet e pronësisë apo administrimit të pronave, sipas parashikimit të nënndarjes "i", të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, të paraqesin informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i administrimit të kërkesës së paraqitur me shkrim nga Korporata e Investimeve Shqiptare.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare i paraqet raport të detajuar, lidhur me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila pas konfirmimit të përmbushjes së detyrave, merr në shqyrtim kërkesën e Korporatës së Investimeve Shqiptare, në zbatim të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 724, datë 20.11.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 538, DATË 26.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 36, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi "Qendra/ës Kombëtare të Licencimit (QKL)" zëvendësohet me "Qendra/ës Kombëtare të Biznesit".

2. Fjalia e dytë, e shkronjës "ç", të pikës 8, të kreut II, "Për këto lloje dokumentesh shoqëruese vlen edhe përcaktimi i shkronjës "d", të pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi." shfuqizohet.

3. Në kreun VIII bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 shfuqizohet.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon*:*

"2. Tarifat e posaçme sektoriale, të lidhura me një licencë të caktuar janë të pagueshme në masën, kështet dhe mënyrat e përcaktuara nga legjislacioni sektorial në fuqi.".

c) Pika 3 shfuqizohet.

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Përcaktimi i pikës 2, të këtij kreu, vlen edhe për autorizimet e pranueshme nga QKB-ja.".

4. Pika 2, e kreut XI, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Duke filluar nga data e përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, ministritë dhe institucionet e tjera nuk pranojnë kërkesa për këto kategori/nënkategori licencash.".

5. Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime:

a) Kategoria I.2, "Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile", shfuqizohet.

b) Në kategorinë 1.3, "Shërbimi privat i sigurisë fizike", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Emërtimi i nënkategorisë I.3.A ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Sigurimi fizik i objekteve shtetërore dhe private, i personave, si dhe i veprimtarive social-kulturore sportive, fetare e politike.".

ii. Emërtimi i nënkategorisë I.3.B ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe i sendeve të çmuara gjatë transportit.".

c) Në kategorinë II.2 bëhen këto ndryshime:

i. Fjalia e parë, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në 3 nënkategori si vijon: ...".

ii. Shkronja "c", e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) "Klinika veterinare/Spital veterinar", me kodin II.2.C".

ç) Në kategorinë II.3 bëhen këto ndryshime:

i. Në pikën 6, fjalët "… më poshtë ..." zëvendësohen me "... më lart ...".

ii. Shkronja "a", e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Institucioni tjetër që verifikon plotësimin e kritereve të licencimit për veprimtaritë me kodin II.3.A është Shërbimi Zooteknik.".

d) Në kategorinë II.5 bëhen këto ndryshime:

i. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Ndërsa licenca e tregtimit me shumicë, me kodin II.5.B.2 përfshin edhe të drejtën e subjektit të licencuar për tregtim me shumicë, që të tregtojë me pakicë mallin e prodhuar në vendin (stabilimentin) në të cilin është bërë licencimi.".

ii. Në pikën 13, fjalët "... grupit I ..." zëvendësohen me "... grupit II ...".

iii. Shkronja "a", e pikës 17, të kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kritereve të licencimit për veprimtaritë e specifikuara me kodin II.5.C.1 dhe II.5.C.2 është Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, vendimi i së cilës bazohet në vlerësimin e dokumenteve të paraqitura

dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së rregullave me standardet e detyrueshme tekniko-teknologjike.”.

dh) Në shkronjën “b”, të pikës 9, të nënkategorisë II.6.B, afati “... 15 ditë ...” zëvendësohet me “... 30 ditë ...”.

e) Në kategorinë II.8 bëhen këto ndryshime:

i. Në fjalinë e parë, të pikës 2, fjalët “... dy nënkategori ...” zëvendësohen me “... tri nënkategori ...”.

ii. Në pikën 3, fjalët “... apo të dy ...” zëvendësohen me “... apo të tre...”.

ë) Titulli dhe përmbajtja e kategorisë III.3 ndryshohen sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

f) Emërtimi i kategorisë III.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“SHFRYTËZIMI DHE/OSE KULTIVIMI I FLORËS (TOKËSORE DHE/OSE UJORE)”.

g) Tabela 1, e kategorisë III.5, të kreut II, nënkategoria III.5.A.1, që përmendet në pikën 7, zëvendësohet me tabelën nr. 1, në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

gj) Numërtimi i kategorisë “SHËRBIME EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE TË LIDHURA ME BURIMET MJEDISORE BAZË”, nga “Kategoria II.7” bëhet “Kategoria III.7”.

h) Pika 2.2, e nënkategorisë VII.3.B, shfuqizohet.

i) Në kategorisë VII.6 bëhen këto ndryshime:

i. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Veprimtaritë e kësaj kategorie futen në nënkategorinë: “Licencë për sipërmarrësit hekurudhorë”.”.

ii. Në pikën 3, fjalët “... në ligjin nr. 9317, datë 18.11.2004, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ...” zëvendësohen me “... në ligjin nr. 142/2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë ...”.

j) Në kategorinë VII.7 bëhen këto ndryshime;

i. Shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, të pikës 2, shfuqizohen.

ii. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Licencat e nënkategorisë VII.7.1 trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesës prej tij dhe afatet për t’iu përgjigjur QKB-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKB-ja, për nënkategoritë VII.7.1 janë përkatësisht ato të përcaktuara në ligjin nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.”.

k) Në kategorinë IX.1 bëhen këto ndryshime:

i. Në shkronjën “b”, të pikës 2, të kreut I, fjalët “... kodi IX.B ...” zëvendësohen me “... kodin IX.1.B ...”

ii. Titulli i kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORIVE IX.1.A.”.

iii. Titulli i kreut III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORIVE IX.1.B.”.

iv. Fjalia e parë, e pikës 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Licencimi i këtyre veprimtarive, në përputhje me kriteret specifike përkatëse, bëhet sipas të njëjtave procedura si ato të nënkategorisë IX.1.A me ndryshimin, që: ...”.

l) Në kategorinë X.1, titulli i kreut III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË X.1.B.”

ll) Emërtimet e ligjeve të referuara si baza ligjore për kategoritë e licencave ndryshohen përkatësisht për secilën prej tyre, sipas tabelës nr. 1, në aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Në aneksin 2, bashkëlidhur vendimit, në ndarjen “Fusha VIII”, shkronjëzimi “B”, në kolonën “Kodi i nënkategorisë”, të nënndarjes për “Veprimtari të lidhura me burime me rrezatim jonizues”, zëvendësohet me “C”.

7. Në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit, nënndarja 16 e tabelës “Përmbajtja orientuese e kërkesës për licencë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 1
KATEGORIA III.3
IMPORTI I SUBSTANCAVE OZONHOLLUESE DHE IMPORT, EKSPORT, MAGAZINIM DHE VENDOSJE NË TREG TË GAZEVE SERRË TË FLUORUARA, TË PAJISJEVE QË PËRMBAJNË GAZE SERRË TË FLUORUARA, OSE FUNKSIONIMI I TË CILAVE MBËSHTETET NË KËTO GAZE

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e "importit të substancave ozonholluese" dhe veprimtaria e "importit, eksportit, magazinimit dhe vendosjes në treg të gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara, ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze" bën pjesë në kategorinë III.3 të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori, si vijon:

a) Importi i substancave ozonholluese, me kodin III.3.A;

b) Importi, eksporti, magazinimi dhe vendosja në treg e gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze", me kodin III.3.B.

3. Licencat e dy nënkategorive janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARISË TË NËNKATEGORISË III.3.A IMPORTI I SUBSTANCAVE OZONHOLLUESE

1. Nënkategoria e kësaj veprimtarie përfshin vetëm përdorimin dhe/ose zëvendësimin e lëndëve ozonholluese nëpërmjet importimit.

2. Licenca për nënkategorinë III.3.A është pa afat dhe jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria.

3. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për nënkategorinë me kodin III.3.A jepen në tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	Drejtuesi teknik	a) Certifikatë për drejtuesin teknik b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) Mjediset b) Pajisjet	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve

4. Licencimi i nënkategorisë III.3.A bëhet sipas procedurës së grupit III.

a) Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kritereve të licencimit është struktura përgjegjëse e ministrisë për mjedisin, e caktuar me udhëzim të ministrit sipas kompetencës territoriale në vendin ku ushtrohet veprimtaria. Vendimi bazohet në dokumentet provuese dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së kritereve përkatëse të licencimit.

b) Afati i marrjes së vendimit është 20 ditë.

5. Licencimi i veprimtarisë III.3.A fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE IMPORT, EKSPORT, MAGAZINIM DHE VENDOSJE NË TREG TË GAZEVE SERRË TË FLUORUARA, TË PAJISJEVE QË PËRMBAJNË GAZE SERRË TË FLUORUARA OSE FUNKSIONIMI I TË CILAVE MBËSHTETET NË KËTO GAZE

1. Veprimtaritë e nënkategorisë III.3.B ndahen në:

a) importi, eksporti, magazinimi i gazeve serrë të fluoruara, i pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze, për të cilat lëshohet licenca me kodin III.3.B.1,

b) vendosja në treg e gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze, për të cilat lëshohet licenca me kodin III.3.B.2.

2. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për veprimtarinë me kodin III.3.B.1 përcaktohen në tabelën 2 dhe kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për veprimtarinë me kodin III.3.B.2 në tabelën 3 më poshtë:

Tabela 2

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit.	Drejtuesi teknik	a) Diplomën për arsimin e mesëm ose të lartë b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) Mjediset b) Pajisjet	a)dokumentin e pronësisë ose kontratën e përdorimit të mjediseve ku sipërmarrësi do të operojë me gaze serrë të fluoruara ose pajisje që përmbajnë këto gaze, b)vetëdeklarim mbi përshtatshmërinë e mjediseve për importin, eksportin, magazinimin e gazeve serrë dhe të pajisjeve që përmbajnë këto gaze

Tabela 3

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit.	Drejtuesi teknik[2]	a) Diplomën për arsimin e mesëm ose të lartë b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës c) kontrata me person të certifikuar nga një organ i akredituar për certifikim personi në fushën e veprimtarive me gazet serrë të fluoruara;
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a) Mjediset b) Pajisjet	a) dokumentin e pronësisë ose kontratën e përdorimit të mjediseve ku sipërmarrësi do të operojë me gaze serrë të fluoruara ose pajisje që përmbajnë këto gaze, b) vetëdeklarim mbi përshtatshmërinë e mjediseve për importin, eksportin, magazinimin e gazeve serrë dhe të pajisjeve që përmbajnë këto gaze

3. Licencimi i nënkategorisë III.3.B.1 dhe III.3.B.2 bëhet sipas procedurës së grupit III të ligjit.

a) Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kritereve të licencimit është struktura në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, e caktuar me udhëzim të ministrit sipas kompetencës territoriale në vendin ku ushtrohet veprimtaria. Vendimi bazohet në dokumentet provuese dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së kritereve përkatëse të licencimit.

b) Afati i marrjes së vendimit është 15 ditë.

4. Licencimi i nënkategorisë III.3.B.1 fillon pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe licencimi i veprimtarisë III.3.B.2 për vendosjen në treg të gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze sipas këtij vendimi fillon 18 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Subjektet që kombinojnë shërbimet e parashikuara në kategorinë III.3.B mund të kërkojnë veçmas ose njëkohësisht licencë për të dyja veprimtaritë. Shqyrtimi i kërkesave për këto veprimtari bëhet sipas procedurave përkatëse.

ANEKS 2

Tabela nr. 1

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit	a)Mjeti lundrues (sipas llojit të peshkimit); b)Mjetet stacionare të peshkimit dhe të ruajtjes së peshkut sipas llojit të peshkimit.	a)Për mjetin lundrues si hyrje e re në flotën e peshkimit: i. leje lundrimi për mjete lundrimi peshkimi me gjatësi më të vogël se 15 metra, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare; ose

[2] Drejtuesi teknik kryen funksionet e operatorit sipas ligjit nr. 2/2023, "Për gazet serrë të fluoruara".

		ii. certifikatë regjistrimi, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për mjetet e tjera lundruese; b)Për mjetin lundrues të regjistruar në flotën e peshkimit por të cilit i rinovohet leja: i. vetëdeklarim duke përcaktuar se mjeti lundrues nuk ka ndryshime të të dhënave lidhur me lejen e mëparshme të peshkimit; ii. në rast se mjeti lundrues ka ndryshuar ndonjë të dhënë të tij, dokumentet që vërtetojnë ndryshimet e ndodhura nga leja e mëparshme si: certifikatë regjistrimi, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare ose; leje lundrimi për mjete lundrimi me gjatësi më të vogël se 15 metra, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare; c) Për pajisjet: Vetëdeklarim duke specifikuar llojin e mjeteve të përdorura.

ANEKS 3

Tabela nr. 1

Nr.	Kategoria e licencës	Baza ligjore e ndryshuar
1	Aneksi 1, kategoria I.2	-Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile" -Ligji nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"
2	Aneksi 1, kategoria I.3	-Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile" -Ligji nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" -Ligji nr. 74/2014 "Për armët"
3	Aneksi 1, kategoria II.2	-Ligji nr. 10465/2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
4	Aneksi 1, kategoria II.3	-Ligji nr. 10465/2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
5	Aneksi 1, kategoria II.5	-Ligji nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", i ndryshuar -Ligji nr. 17/2020, "Për produktet plehëruese" -Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar.
6	Aneksi 1, kategoria II.6	-Ligji nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" -Ligji nr. 10454, datë 21.7.2011, "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
7	Aneksi 1, kategoria II.7	-Ligji nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar -Ligji nr. 10465/2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
8	Aneksi 1, kategoria III.3	-Vendimi nr. 10/2019 "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca" -Urdhri nr. 166/2019, "Për procedurat dhe dokumentacionin për pajisjen me licencën e "importit të substancave ozonholluese" -Ligji nr. 2/2023, "Për gazet serrë të fluoruara"
9	Aneksi 1, kategoria III.4	-Ligji nr. 10081/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
10	Aneksi 1, kategoria III.5	-Ligji nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", i ndryshuar -Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010, "Për gjuetinë", i ndryshuar, dhe ligji nr. 10006, datë 23.10.2008, "Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër" -Ligji nr. 10081/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
11	Aneksi 1, kategoria III.7	-Ligji nr. 29/2024, "Për burimet ujore"
12	Aneksi 1, kategoria IV.4	-Ligji nr. 10304/2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
13	Aneksi 1, kategoria VII.6	-Ligji nr. 142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" -Vendimi nr. 657, datë 31.10.2018 "Për përcaktimin e Autoritetit Licencues Hekurudhor"
14	Aneksi 1, kategoria VII.7	-Ligji nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë"
15	Fusha VIII	-Ligji nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve"
16	Fusha IX	-Ligji nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"
17	Aneksi 1, kategoria X.2	-Ligji nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" -Ligji nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"

VENDIM
Nr. 726, datë 20.11.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 7.2.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE E TË KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË *STARTUP*-et DHE LEHTËSUESIT E *STARTUP*-eve, TË PROCEDURAVE E TË AFATEVE, SI DHE TË RREGULLAVE PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE ANKIMIT, KRITEREVE, PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES E TË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 14, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4, të kreut V, të vendimit nr. 61, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi "... brenda 10 (dhjetë) ditëve ..." zëvendësohet me "... brenda 30 (tridhjetë) ditëve ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 727, datë 20.11.2024

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 867, DATË 10.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës "g", të pikës 2, të nenit 6, të shtojcës A, "Marrëveshje bashkëpunimi (tip)", bashkëlidhur vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", të ndryshuar, shtohet shkronja "gj", me këtë përmbajtje:

"gj) në rastet kur evidentimi në terren kryhet nga specialistët e bashkisë, akti i evidentimit në terren nënshkruhet prej tyre, sipas formatit të miratuar në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.".

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të gjitha bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 728, datë 20.11.2024

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ANTIKORRUPSIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të kreut III, të vendimit nr. 436, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit", me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Insidor Rexhepi emërohet drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 250, datë 25.10.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MODALITETET E LLOGARITJES SË KOSTOS QË SHKAKTOHET DREJTPËRDREJT SI REZULTAT I FUNKSIONIMIT TË TRENAVE DHE APLIKIMIT TË TARIFIMIT PËR KOSTON E EFEKTEVE TË ZHURMËS"[3]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 30, 31, 32, 33 dhe 34, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për modalitetet e llogaritjes së kostos që shkaktohet drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit të trenave dhe aplikimit të tarifimit për koston e efekteve të zhurmës", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen administratorët e infrastrukturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR MODALITETET E LLOGARITJES SË KOSTOS QË SHKAKTOHET DREJTPËRDREJT SI REZULTAT I FUNKSIONIMIT TË TRENAVE DHE APLIKIMIT TË TARIFIMIT PËR KOSTON E EFEKTEVE TË ZHURMËS

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i modaliteteve që duhen ndjekur nga administratori i infrastrukturës për llogaritjen e kostove të shkaktuara drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit të trenit dhe për aplikimin e tarifës për koston e efekteve të zhurmës të shkaktuara nga mjetet hekurudhore të transportit të mallrave.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i tarifave të përdorimit të infrastrukturës hekurudhore, për paketën minimale të aksesit dhe aksesin në objektet e shërbimit që lidhin infrastrukturën e përmendur në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", në vijim Kodit, dhe aplikimin e tarifës së efekteve të zhurmës.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet brenda kornizës së tarifimit, siç parashikohet në nenin 30, pika 1 e Kodit, kur ministri përgjegjës për transportin ka vendosur të prezantojë modifikimin e tarifave të infrastrukturës në përputhje me nenin 32, pikën 5, nënparagrafin e parë, të Kodit.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për vagonët që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) vagonët që kanë një shmangie nga specifikimi teknik për ndërveprueshmërinë, në lidhje me nënsistemin "mjete hekurudhore – zhurma", në vijim TSI zhurma, sipas nenit 134 të Kodit;

[3] *Kjo rregullore përafron plotësisht me:*
- Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2015/909, datë 12 qershor 2015, "Mbi modalitetet për llogaritjen e kostos që shkaktohet drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit të trenit", (tekst me rëndësinë e ZEE-së), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian OJ L 148, datë 13.6.2015, f. 17–22.
- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2015/429, datë 13 mars 2015, "Përcaktimi i modaliteteve që duhen ndjekur për aplikimin e tarifimit për koston e efekteve të zhurmës", (Tekst me rëndësi për ZEE-në), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian OJ L 70, datë 14.3.2015, f. 36–42.

b) vagonët për të cilët nuk ka blloqe frenash të përbëra në përputhje me TSI vagon, të cilat mund të montohen drejtpërdrejt në vagon pa modifikim të mëtejshëm të sistemit të frenimit ose prova të dedikuara;

c) vagonët që vijnë nga vendet e treta dhe që qarkullojnë në rrjetin e gjerësisë hekurudhore 1 520 ose 1 524 mm dhe që janë dhënë një rast specifik në TSI zhurma ose përjashtohen nga objekti i tij.

3. Bonusi dhe malusi që rezultojnë nga diferencimi i tarifave të aksesit në trase sigurojnë akses jodiskriminues dhe transparent në infrastrukturë.

4. Diferencimi i tarifave të hyrjes në infrastrukturë sipas kësaj rregulloreje nuk cenon zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.

5. Kjo rregullore zbatohet pa cenuar dispozitat, në lidhje me financimin e infrastrukturës ose ekuilibrin e të ardhurave dhe shpenzimeve të administratorit të infrastrukturës, të përcaktuara në nenin 11 të Kodit.

Neni 4
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.“kosto direkte” nënkupton koston që shkaktohet drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit të trenit;

2. “kosto direkte për njësi” nënkupton koston direkte për tren kilometër, mjet kilometër, ton kilometër bruto i një treni ose një kombinim i tyre;

3. “njësia e kostos” nënkupton një njësi biznesi brenda sistemit të kontabilitetit të administratorit të infrastrukturës, së cilës i ndahen kostot për hir të ndarjes së këtyre kostove drejtpërdrejt ose tërthorazi në një shërbim të afruar.

4. “skemë” nënkupton dispozita që vendosin tarifat e hyrjes në infrastrukturë të diferencuar nga zhurma që do të miratohen dhe zbatohen nga administratorët e infrastrukturës;

5. “vagonë të rinovuar” nënkupton vagonët ekzistues të pajisur me blloqe frenash të përbëra në përputhje me kërkesat e përcaktuara në TSI zhurma;

6. “vagonë pa zhurmë” nënkupton vagonët e rinj ose ekzistues që respektojnë vlerat kufitare përkatëse të zhurmës, të përcaktuara në TSI zhurma;

7. “vagonë me zhurmë” nënkupton vagonët që nuk respektojnë vlerat kufitare përkatëse të zhurmës të përcaktuara në TSI zhurma;

8. “tren i zhurmshëm” nënkupton një tren të përbërë nga më shumë se 10% vagonë me zhurmë;

9. “tren pa zhurmë” nënkupton një tren i cili përbëhet nga të paktën 90% vagonë pa zhurmë;

10. “vagonë dhe lokomotiva pa zhurmë” nënkupton vagonët dhe lokomotivat me emetim zhurmash të paktën 3 dB nën vlerat përkatëse të përcaktuara në TSI zhurma;

11. “bonus për vagonët e rinovuar” nënkupton një zbritje të detyrueshme nga tarifat e aksesit në infrastrukturë për sipërmarrjet hekurudhore që përdorin vagonë të rinovuar;

12. “bonusi i trenit” nënkupton një zbritje fakultative për sipërmarrjet hekurudhore për çdo “tren pa zhurmë”;

13. “bonus për vagonët ose lokomotivat pa zhurmë” nënkupton një zbritje opsionale për sipërmarrjet hekurudhore për çdo vagon dhe lokomotivë pa zhurmë;

14. “malus” nënkupton një shtesë opsionale për tarifat e aksesit në infrastrukturë që duhet paguar nga sipërmarrjet hekurudhore për çdo tren me zhurmë.

Neni 5
Kostot direkte të rrjetit

1. Kostot direkte mbi bazën e të gjithë rrjetit llogariten si diferencë midis, nga njëra anë, kostove për ofrimin e shërbimeve të paketës minimale të aksesit dhe për aksesin në objektet e shërbimit që lidhin infrastrukturën dhe, nga ana tjetër, kostot e papranueshme të përmendura në nenin 6.

2. Ministri përgjegjës për transportin mund të vendosë që administratori i infrastrukturës të zbatojë kostot e ofrimit të shërbimeve efikase për qëllime të llogaritjes së kostove direkte në bazë të rrjetit të referuar në paragrafin 1.

3. Vlerat e aseteve të përdorura për qëllimin e llogaritjes së kostove direkte në të gjithë rrjetin bazohen në vlerat fillestare ose, kur këto vlera nuk janë të disponueshme, ose kur vlerat aktuale janë më të ulëta, në vlerat aktuale. Vlerat fillestare të aseteve bazohen në shumat e paguara dhe të dokumentuara nga administratori i infrastrukturës në momentin e blerjes së këtyre aseteve. Në rast të një lehtësimi borxhi, ku të gjitha ose një pjesë e borxheve të

administratorit të infrastrukturës janë marrë përsipër nga një njësi tjetër, administratori i infrastrukturës t'i atribuojë një pjesë përkatëse të lehtësimit të borxhit për të reduktuar vlerat e aseteve të tij dhe kostot përkatëse direkte në të gjithë rrjetin. Me përjashtim nga fjalia e parë, administratori i infrastrukturës mund të aplikojë vlera duke përfshirë vlerat e vlerësuara ose vlerat aktuale, ose vlerat zëvendësuese nëse ato mund të maten në mënyrë transparente, të qëndrueshme dhe objektive, dhe të justifikohen siç duhet për Autoritetin Rregullator Hekurudhor, më poshtë Autoriteti Rregullator.

4. Pa paragjykuar nenin 6 dhe nëse administratori i infrastrukturës mundet të matë në mënyrë transparente dhe objektive, dhe të demonstrojë, ndër të tjera, mbi praktikat më të mira ndërkombëtare, që kostot shkaktohen drejtpërdrejt nga funksionimi i shërbimit të trenit, administratori i infrastrukturës mund të përfshijë në llogaritjen e kostove të tij direkte në të gjithë rrjetin, veçanërisht kostot e mëposhtme:

a) kostot e personelit të nevojshëm për mbajtjen hapur të një pjese të caktuar të linjës nëse një kërkues kërkon të kryejë një shërbim specifik treni të planifikuar jashtë orarit të rregullt të hapjes së kësaj linje;

b) pjesa e kostove të infrastrukturës, duke përfshirë ndërprerjet dhe kalimet, që janë të ekspozuara ndaj konsumimit nga shërbimi i trenit;

c) pjesën e kostove të rinovimit dhe mirëmbajtjes së linjës ajrore elektrike ose të hekurudhës së elektrifikuar, ose të dyjave dhe të pajisjeve mbështetëse të linjës ajrore të shkaktuara drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit të trenit;

ç) kostot e personelit të nevojshëm për përgatitjen e alokimit të rrugëve të trenave dhe orarin në masën që ato shkaktohen drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të shërbimit të trenave.

5. Kostot e përdorura për llogaritjen sipas këtij neni bazohen në pagesat e kryera ose të parashikuara nga administratori i infrastrukturës. Kostot e llogaritura sipas këtij neni maten ose parashikohen në mënyrë të vazhdueshme mbi bazën e të dhënave nga e njëjta periudhë kohore.

Neni 6
Kostot e papranueshme

1. Administratori i infrastrukturës nuk do të përfshijë në llogaritjen e kostove direkte të rrjetit, veçanërisht kostot e mëposhtme:

a) kostot fikse që lidhen me sigurimin e një shtrirjeje të linjës që administratori i infrastrukturës duhet të përballojë edhe në mungesë të lëvizjeve të trenave;

b) kostot që nuk kanë të bëjnë me pagesat e bëra nga administratori i infrastrukturës. Kostot ose njësia e kostos që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me ofrimin e paketës minimale të aksesit, ose me aksesin në objektet e shërbimit që lidhin infrastrukturën;

c) kostot e blerjes, shitjes, çmontimit, dekontaminimit, rikultivimit ose marrjes me qira të tokës, ose aseteve të tjera fikse;

ç) kostot e përgjithshme të rrjetit, duke përfshirë pagat dhe pensionet;

d) kostot e financimit;

dh) kostot që lidhen me përparimin teknologjik ose vjetërsimin;

e) kostot e aktiveve jomateriale;

ë) kostot e sensorëve anash trasesë, pajisjeve të komunikimit në anë të trasesë dhe pajisjeve të sinjalizimit nëse nuk shkaktohen drejtpërdrejt nga funksionimi i shërbimit të trenit;

f) kostot e informacionit, pajisjet e komunikimit të vendosura jashtë shinave ose pajisjet e telekomunikacionit;

g) kostot që lidhen me incidentet individuale të forcës madhore, aksidentet dhe ndërprerjet e shërbimit pa paragjykuar nenin 36 të Kodit;

gj)kostot e pajisjeve të furnizimit me energji elektrike për rrymën tërheqëse nëse nuk shkaktohen drejtpërdrejt nga funksionimi i shërbimit të trenit. Kostot direkte të funksionimit të shërbimeve të trenave që nuk përdorin pajisje të furnizimit me energji elektrike, nuk përfshijnë kostot e përdorimit të pajisjeve të furnizimit me energji elektrike;

h) kostot që lidhen me dhënien e informacionit për të zbatuar ose përdorur shërbimin për të cilin është dhënë kapaciteti, përveç rasteve kur shkaktohen nga funksionimi i shërbimit të trenit;

i) kostot administrative të shkaktuara nga skemat e tarifave të diferencuara për të marrë parasysh koston e efekteve mjedisore të shkaktuara nga operimi i trenit, të referuara në nenin 32, pikën 5, të

Kodit dhe koston për të dhënë stimuj për pajisjen e trenave me ETCS;

j) amortizimi i cili nuk përcaktohet në bazë të konsumit real të infrastrukturës për shkak të funksionimit të shërbimit të trenit;

k) pjesa e kostove të mirëmbajtjes dhe rinovimit të infrastrukturës civile që nuk lind drejtpërdrejt nga funksionimi i shërbimit të trenave.

2. Nëse administratori i infrastrukturës ka marrë fonde për të financuar investime të veçanta në

infrastrukturë, të cilat nuk është i detyruar t'i shlyejë dhe kur këto investime merren parasysh në llogaritjen e kostove direkte, kostot e këtyre investimeve nuk do të rrisin nivelin e tarifave pa paragjykim të nenit 33 të Kodit.

3. Kostot e përjashtuara nga llogaritja në bazë të këtij neni maten ose parashikohen në bazë të periudhës kohore të përmendur në nenin 5, pika 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Llogaritja dhe modifikimi i kostove direkte për njësi

1. Administratori i infrastrukturës llogarit kostot mesatare të drejtpërdrejta për njësi për të gjithë rrjetin duke pjesëtuar kostot direkte të rrjetit me numrin total të mjet/kilometrave, tren/ kilometrave ose ton kilometrave bruto të parashikuara ose të operuara në fakt.

a) Përndryshe, nëse administratori i infrastrukturës i demonstron Autoritetit Rregullator të përmendur në nenin 55 të Kodit, se vlerat ose parametrat e përmendur në paragrafin 2, janë dukshëm të ndryshëm për pjesë të ndryshme të rrjetit të tij, dhe pas ndarjes së rrjetit të tij në pjesë të tilla, administratori i infrastrukturës llogarit kostot mesatare të drejtpërdrejta për njësi për pjesët e rrjetit të tij, duke pjesëtuar kostot direkte për këto pjesë me numrin total të mjet/kilometrave, tren/kilometrave ose ton kilometrave bruto të parashikuara ose të operuara në fakt. Periudha e parashikimit mund të mbulojë disa vjet;

b) Për të llogaritur kostot mesatare të drejtpërdrejta të njësisë, administratori i infrastrukturës mund të përdorë një kombinim të mjet/kilometrave, tren/kilometrave ose ton kilometrave bruto, me kusht që kjo metodë llogaritjeje të mos ndryshojë lidhjen e drejtpërdrejtë shkakësore me funksionimin e shërbimit të trenit. Pa cenuar nenin 5, pika 3, administratori i infrastrukturës mund të aplikojë kostot e rezultateve ose të parashikimit.

2. Ministri përgjegjës për transportin mund të lejojë administratorin e infrastrukturës të modifikojë kostot mesatare të drejtpërdrejta të njësisë për të marrë parasysh nivelet e ndryshme të konsumimit të shkaktuara në infrastrukturë sipas një ose më shumë prej parametrave të mëposhtëm:

a) gjatësia e trenit dhe/ose numri i vagonëve në tren;

b) peshës së trenit;

c) lloji i mjetit, në veçanti masa e tij e pandërprerë (shasia);

ç) shpejtësia e trenit;

d) fuqia tërheqëse e njësisë së motorizuar;

dh) pesha për aks dhe/ose numrat e akseve;

e) numri i regjistruar i rrotave ose përdorimi efektiv i pajisjeve mbrojtëse kundër rrëshqitjes së rrotave;

ë) ngurtësia gjatësore e mjeteve dhe forcat horizontale që ndikojnë në trase;

f) fuqia elektrike e konsumuar dhe e matur ose pantografi dhe sistemi i linjës së kontaktit elektrik, dinamika e pantografëve ose e kontakteve elektrike si parametra për vlerësimin e konsumimit të kontaktit ajror të sipërm, ose të shiritit elektrik;

g) parametrat e trasesë, në veçanti rrezet;

gj) çdo parametër tjetër që lidhet me koston, ku administratori i infrastrukturës mund t'i demonstrojë Autoritetit Rregullator se vlerat për secilin parametër të tillë, duke përfshirë ndryshimin e secilit parametër të tillë kur është e rëndësishme, maten dhe regjistrohen në mënyrë objektive.

3. Një modifikim i kostove të drejtpërdrejta për njësi nuk do të rezultojë në një rritje të kostove direkte të rrjetit, siç referohet në nenin 5, pika 1.

4. Kostot shtesë të shkaktuara nga devijimi, i planifikuar ose i paplanifikuar, i trenave me sugjerimin e administratorit të infrastrukturës nuk do të përfshihen në kostot direkte të shkaktuara nga funksionimi i këtyre shërbimeve të trenave. Fjalia e parë nuk do të zbatohet nëse sipërmarrja hekurudhore rimbursohet për ato kosto shtesë nga administratori i infrastrukturës ose devijimi që rezulton nga një procedurë koordinimi bashkëpunimi në përputhje me nenin 46 të Kodit.

5. Numri i përgjithshëm i mjete/kilometrave, tren/kilometrave, ton kilometrave bruto ose një kombinim i atyre të përdorura për qëllimet e

llogaritjeve të bëra sipas këtij neni do të matet ose parashikohet në bazë të periudhës referuese të përmendur në nenin 5, pika 5.

Neni 8
Modelimi i kostos

Duke përjashtuar nenin 5, pika 1 dhe fjalinë e parë, të nenit 7, pika 1, administratori i infrastrukturës mund të llogarisë kostot e drejtpërdrejta për njësi me anë të modelimit të kostos ekonometrike ose inxhinierike të evidentuar në mënyrë të qartë, me kusht që t'i tregojë Autoritetit Rregullator se kostot direkte njësi përfshijnë vetëm kostot direkte të shkaktuara nga funksionimi i shërbimit të trenit dhe, në veçanti, nuk përfshijnë asnjë nga kostot e përmendura në nenin 6.

Autoriteti Rregullator ka të drejtë t'i kërkojë administratorit të infrastrukturës të llogarisë për krahasim kostot e drejtpërdrejta për njësi, në përputhje me nenin 5, pika 1 dhe nenin 7, pika 1 ose me anë të modelimit të kostos në përputhje me fjalinë e parë.

Neni 9
Kontroll i thjeshtuar

1. Nëse kostot direkte në bazë të rrjetit, të referuara në nenin 5, pika 1 ose kostot direkte të llogaritura në bazë të modelimit të përmendur në nenin 8, të shumëzuara me numrin e tren/kilometrave, mjete/kilometrave dhe/ose ton kilometër bruto, operuar në periudhën e referencës, janë ose më pak se 15 % të kostove të plota të mirëmbajtjes dhe rinovimit, ose më pak se shuma prej 10% e kostove të mirëmbajtjes dhe 20% e kostove të rinovimit, Autoriteti Rregullator ka të drejtë të kryejë kontrollin e përmendur në nenin 56, pika 2 të Kodit, mbi llogaritjen e kostove direkte në bazë të rrjetit në një mënyrë të thjeshtuar.

a) Ministri përgjegjës për transportin ruan të drejtën të vendosë rritjen e përqindjeve të përmendura në këtë paragraf në jo më shumë se dyfishin e vlerave të treguara.

2. Autoritetit Rregullator mund të pranojë llogaritjen e kostove mesatare të drejtpërdrejta për njësi të përmendura në nenin 7, pika 1, dhe kostot mesatare të moduluara direkte për njësi të përmendura në nenin 7, pika 2, dhe/ose modelimin e kostos të përmendur në nenin 8, subjekt i kontrollit të thjeshtuar të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nëse kostot mesatare direkte për tren/kilometër të një treni 1 000 ton janë jo më shumë se 2 euro.

3. Kontrollet e thjeshtuara të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, zbatohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Kontrollet e thjeshtuara nuk do të paragjykojnë nenet 32 ose 56 të Kodit.

4. Autoriteti Rregullator përcakton detajet e kontrollit të thjeshtuar.

Neni 10
Rishikimi i llogaritjes

Administratori i infrastrukturës përditëson rregullisht metodën e llogaritjes së kostove të tij direkte, duke marrë parasysh, ndër të tjera, praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Neni 11
Skema

1. Mbi bazën e modaliteteve të përcaktuara në këtë rregullore, administratori i infrastrukturës miraton një skemë që diferencon tarifat e infrastrukturës në varësi të nivelit të zhurmës së prodhuar dhe e cila zbatohet për të gjitha sipërmarrjet hekurudhore në fjalë. Zbatimi i kësaj skeme nuk do të rezultojë në shtrembërim të panevojshëm të konkurrencës ndërmjet sipërmarrjeve hekurudhore ose të ndikojë negativisht në konkurrencën e përgjithshme të sektorit të transportit hekurudhor.

2. Skema do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2030.

Neni 12
Bonusi për vagonët e rinovuar

1.Administratorët e infrastrukturës paraqesin një bonus për sipërmarrjet hekurudhore që përdorin vagonë të rinovuar. Niveli i bonusit do të jetë i njëjtë në të gjithë rrjetin e administratorit të infrastrukturës dhe do të zbatohet për çdo vagon të rinovuar.

2. Baza për llogaritjen e nivelit të bonusit do të jetë numri i akseve të një vagoni dhe sasia e kilometrave të realizuara në një periudhë të caktuar nga administratori i infrastrukturës.

3. Niveli minimal i bonusit vendoset në 0,0035 euro për km aks.

4. Gjatë përcaktimit të nivelit të bonusit, administratori i infrastrukturës konsideron dhe inflacionin, kilometrazhin e realizuar nga vagonët dhe kostot e funksionimit të lidhura me përdorimin e vagonëve të rinovuar.

5. Niveli i bonusit i llogaritur në përputhje me paragrafin 3 dhe, sipas rastit, paragrafin 4, të këtij neni, përcaktohet për të paktën 1 vit.

6. Administratorët e infrastrukturës vendosin të anulojnë ose të ulin nivelin e bonusit me vlerën e kostove të rinovimit për ato vagonë që kishin marrë tashmë pagesa bonus, të cilat i lejojnë ata të rimbursojnë kostot e riparimit.

Neni 13
Bonusi i trenit

1. Administratorët e infrastrukturës paraqesin një bonus për sipërmarrjet hekurudhore që drejtojnë trena pa zhurmë.

2. Bonusi i trenit zbatohet për çdo tren pa zhurmë.

3. Shuma e bonusit për trenin pa zhurmë do të jetë maksimumi 50% e vlerës totale të shpërblimeve të zbatueshme për vagonët e rinovuar që përbëjnë atë tren dhe llogaritet në përputhje me nenin 12.

4. Bonusi për trenin pa zhurmë do të jetë progresiv me shpërblimet e përmendura në nenet 12 dhe 14.

Neni 14
Bonus për vagonët dhe lokomotivat pa zhurmë

1. Administratorët e infrastrukturës paraqesin një bonus për sipërmarrjet hekurudhore që drejtojnë vagonë dhe lokomotiva pa zhurmë.

2. Bonusi i përmendur në paragrafin 1 zbatohet për çdo vagon dhe lokomotivë pa zhurmë.

3. Shuma e bonusit për çdo vagon dhe lokomotivë pa zhurmë korrespondon proporcionalisht me uljen e niveleve të zhurmës nën këto vlera kufi dhe do të jetë maksimumi 50% e vlerës së bonusit të zbatueshëm për vagonin e rinovuar siç llogaritet në përputhje me nenin 12.

4. Bonusi për vagonët dhe lokomotivat pa zhurmë do të jetë progresiv me shpërblimet e përmendura në nenet 12 dhe 13.

Neni 15
Malus

1. Administratorët e infrastrukturës paraqesin një malus për sipërmarrjet hekurudhore që drejtojnë trena me zhurmë.

2. Malus zbatohet për çdo tren të zhurmshëm.

3. Shuma totale e malusit të paguar gjatë kohëzgjatjes së skemës nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e shpërblimeve të përmendura në nenet 12, 13 dhe 14.

4. Administratorët e infrastrukturës lejohen të mos zbatojnë paragrafin 3 nëse tarifa e ngjashme e kostos së zhurmës zbatohet për transportin rrugor të mallrave, në përputhje me nenin 32, pika 5, nënparagrafi i dytë i Kodit.

5. Me përjashtim të nenit 11, ministri përgjegjës për transportin mund të vendosë të vazhdojë aplikimin ose të paraqesë një malus pas përfundimit të kohëzgjatjes së skemës, me kusht që një masë e ngjashme të zbatohet për sektorin e transportit rrugor të mallrave, në përputhje me nenin 32, pika 5, nënparagrafi i dytë i Kodit.

6. Kur vendos për të prezantuar malusin dhe përcaktimin e nivelit të tij, administratori i infrastrukturës, sipas rastit, dhe pas konsultimit me palët përkatëse të interesuara, mund të marrë parasysh ndjeshmërinë e zonës së prekur nga trafiku hekurudhor i mallrave, në veçanti madhësinë e popullsisë së prekur dhe ekspozimin ndaj zhurmës së hekurudhave përgjatë vijës hekurudhore.

Neni 16
Procedurat administrative

1. Administratorët e infrastrukturës janë përgjegjës për menaxhimin e skemës, duke përfshirë mbajtjen e llogarive për të ardhurat financiare me sipërmarrjet hekurudhore. Ata vënë në dispozicion të dhënat, në lidhje me këto të ardhura financiare, me kërkesë të autoriteteve kombëtare kompetente gjatë periudhës së aplikimit të skemës dhe në 10 vitet në vijim pas skadimit të skemës.

2. Administratori i infrastrukturës përdor regjistrat ekzistues dhe mjetet e tjera të disponueshme për të mbledhur prova që demonstrojnë statusin e vagonëve ose lokomotivave (në përputhje me rrethanat, të rinovuar, pa zhurmë ose të zhurmshme).

3. Nëse të dhënat e përmendura në paragrafin 2 nuk mund të mblidhen nga regjistrat ose mjetet, administratori i infrastrukturës u kërkon sipërmarrjeve hekurudhore të demonstrojnë statusin e vagonëve dhe lokomotivave që synojnë të përdorin.

a) Në rastin e vagonëve të rinovuar, sipërmarrja hekurudhore duhet të dorëzojë dëshmi teknike ose financiare përkatëse që rinovimi ka ndodhur;

b) Në rastin e vagonëve pa zhurmë, sipërmarrja hekurudhore do të japë një autorizim për vënien në shërbim ose çdo dëshmi ekuivalente;

c) Në rast të vagonëve dhe lokomotivave pa zhurmë, sipërmarrja hekurudhore duhet të dorëzojë prova që vërtetojnë nivelin më të ulët të zhurmës, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, detajet e modifikimeve shtesë të ndërmarra për reduktimin e zhurmës.

4. Masat administrative të zhvilluara në nivel kombëtar për menaxhimin e skemave ekzistuese mund të vazhdojnë të zbatohen për sa kohë që ato janë në përputhje me këtë rregullore.

5. Kostot administrative të skemës nuk do të merren parasysh në përcaktimin e nivelit të bonusit dhe malusit.

6. Administratorët e infrastrukturës që aplikojnë skemën bashkëpunojnë, veçanërisht në lidhje me thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave administrative për aplikimin e tarifës për koston e efekteve të zhurmës të shkaktuara nga mjetet hekurudhore të mallrave, siç parashikohet nga kjo rregullore, duke përfshirë formatin e provave të përmendura në paragrafin 3.

Neni 17
Njoftime

1. Skemat i njoftohen Komisionit përpara se të bëhen të zbatueshme.

2. Pas hyrjes në fuqi të skemës dhe deri më 1 maj të çdo viti vijues, i raportohet Komisionit për vitin e kaluar kalendarik të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) numrin e vagonëve që i nënshtroheshin bonusit të përmendur në nenin 4;

b) aty ku është e aplikueshme, numri i vagonëve dhe lokomotivave që i nënshtrohen bonusit të përmendur në nenin 6;

c) aty ku është e aplikueshme, numri i trenave që i nënshtrohen bonusit të përmendur në nenin 5;

ç) aty ku është e aplikueshme, numri i trenave që i nënshtroheshin malusit;

d) kilometrazhin e drejtuar nga vagonët e rinovuar në shtetin anëtar në fjalë;

dh) kilometrazhi i vlerësuar, i drejtuar nga trenat pa zhurmë dhe të zhurmshëm në shtetin anëtar në fjalë.

3. Me kërkesë të Komisionit sigurohen të dhëna shtesë aty ku ka, që përfshijnë:

a) shumën totale të bonuseve të dhëna për vagonët e rinovuar, trenat, vagonët dhe lokomotivat pa zhurmë;

b) sasinë totale të maluseve të mbledhura;

c) shumën mesatare të bonusit dhe malusit për km aks.

Neni 18
Dispozitat kalimtare

Administratori i infrastrukturës i paraqet Autoritetit Rregullator metodën e tij të llogaritjes së kostove direkte, jo më vonë se data 1 korrik 2027.

Kjo rregullore është detyruese dhe zbatohet drejtpërdrejt në të gjithë rrjetin hekurudhor.

URDHËR
Nr. 98, datë 23.2.2024

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",

URDHËROJ:

1. Licenca, për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore është sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

LICENCË

Nr. _____, datë _____

PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" dhe vendimit të Komisionit të Licencave nr. _____, datë_____.

I JEPET

SUBJEKTIT: _____,
ADRESA: _____,
AFATI: _____,
ZONA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT: _____,
PËR VEPRIMTARITË E MËPOSHTME:
- kultivimin, prodhimin e bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore;
- transportimin e farërave, bimëve dhe produkteve e nënprodukteve të *cannabis*-it për qëllime mjekësore në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- eksportin e bimëve, produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it për qëllime mjekësore.

KUSHTET E LICENCËS:

Kjo licencë lëshohet në përputhje me ligjin nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Subjekti, në ushtrimin e aktivitetit të tij, vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

MINISTËR

(Emër, Mbiemër)
(Firmë)

URDHËR
Nr. 99, datë 23.2.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E PUNËS DHE VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË LICENCAVE, PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE TË PARAQITURA PËR MARRJEN E LICENCËS PËR KULTIVIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 11, pika 8, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për organizimin e punës dhe veprimtarisë së Komisionit të Licencave për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për kultivimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it dhe anëtarët e Komisionit për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN E PUNËS DHE VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË LICENCAVE, PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE TË PARAQITURA PËR MARRJEN E LICENCËS PËR KULTIVIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME MJEKËSORE

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Licencave për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës, këtu e në vijim "Komisioni", për kultivimin e *cannabis*-it, për qëllime mjekësore.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara, për:

a) organizimin e mbledhjeve, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve në mbledhjen e Komisionit;

b) ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit në paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me subjektet që kanë bërë kërkesë për t'u pajisur me licencë, që përbëjnë shkak për pezullimin ose shfuqizimin e licencës;

c) trajtimin dhe administrimin e dokumentacionit që është objekt i shqyrtimit dhe i vendimmarrjes së Komisionit.

Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Komisioni i Licencave ka këto detyra:

a) administron dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet që kanë bërë kërkesë për t'u pajisur me licencë, të vënë në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it;

b) vlerëson plotësimin e kushteve në lidhje me mjediset, pajisjet dhe personelin për marrjen e licencës;

c) harton listën dhe relacionin përkatës në lidhje me subjektet kërkuese, si dhe përgatit propozimin për dhënien ose refuzimin e licencës;

ç) në rast të konstatimit të shkeljeve, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë marrjen e masës administrative të pezullimit apo shfuqizimit të licencës.

2. Komisioni i Licencave është përgjegjës, për:

a) miratimin e kërkesave për shitjen e aksioneve të ortakëve të subjekteve mbajtëse të licencës apo lejes, të përcjella për miratim nga Agjencia *(neni 9, pika 2, shkronja "k")*;

b) shqyrton masat për pezullimin apo shfuqizimin e licencës, të përcjella nga Agjencia *(neni 10, pika 4)*;

c) shqyrtimin e kërkesave për ndryshimet që lidhen me tjetërsimin e pronësisë së subjekteve të licencuara, përmes miratimit ose refuzimit paraprak, brenda 3 muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në lidhje me verifikimin e pastërtisë së figurës *(neni 14, pika 5);*

d) merr vendim për përzgjedhjen e subjektit fitues në procedurën e konkurrimit për licencim *(neni 18, pika 1)*;

e) hartimin e listës përfundimtare të subjekteve, të cilat konkurrojnë për pajisje me licencë duke renditur pjesëmarrësit në konkurrim sipas pikëve të marra në përputhje me skemën e pikëzimit *(neni 18, pika 3)*; miraton skemën e pikëzimit për vlerësimin e subjekteve që aplikojnë për licencim *(neni 18, pika 3)*;

f) verifikimin dhe konstatimin e shkeljeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 21, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", pasi ka dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit mbajtës të licencës *(neni 21, pika 3)*;

g) i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë, pezullimin ose shfuqizimin e licencës *(neni 21, pika 3)*.

3. Në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive të tij, Komisioni harton, miraton dhe publikon jo më vonë se 1 muaj nga kostituimi i Komisionit dhe, në çdo rast para hapjes së procedurave për dorëzimin e kërkesave për licencim të subjekteve, rregulla më të hollësishme për vlerësimin e aplikimeve për licencim dhe përzgjedhjen e subjekteve të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin e përvojës në ushtrimin e aktiviteteve kryesore për të cilat jepet licenca ndërmjet pjesëmarrësve në konkurrim me pikë të barabarta vlerësimi;

b) kriteret për vlerësimin e përvojës etiko-profesionale dhe të integritetit bazuar në parashikimet e udhëzimit për verifikimin e pastërtisë së figurës;

c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta (*neni 18, pika 5*).

Neni 4
Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit zgjidhet një nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me votim të fshehtë, me votat e shumicës së anëtarëve të Komisionit.

2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit janë të pavarur në vendimmarrje që bazohet vetëm në legjislacionin në fuqi.

3. Të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit, janë:

a) të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit;

b) të studiojnë materialet e mbledhjes dhe të marrin pjesë aktive në mbledhje;

c) të njoftojnë drejtuesin e mbledhjes për mosparaqitjen e tyre;

ç) të votojnë për çështjet që do të shqyrtohen;

d) të deklarojnë në mbledhjen e radhës para votimit për çdo çështje konflikti interesash, siç është e parashikuar në nenin 37, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative";

dh) t'i nënshtrohen ruajtjes së sekretit të informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 5
Detyrimi për të marrë pjesë në mbledhje

Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhje, përveç rasteve të përligjura duke njoftuar paraprakisht kryetarin dhe sekretariatin. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm konsiderohet që ka hequr dorë si anëtar i Komisionit. Në këtë rast, kryetari, ose në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në tri mbledhje të njëpasnjëshme, anëtari i zgjedhur nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, njofton menjëherë organin e emërtesës dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë.

Organi i emërtesës fillon procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të Komisionit jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 6
Organizimi i mbledhjeve

1. Komisioni diskuton dhe merr vendimet e nevojshme nëpërmjet mbledhjeve zyrtare të tij të cilat mund të zhvillohen në prezencë ose *online*. Si rregull, mbledhjet zhvillohen në ambientet e Agjencisë dhe në pamundësi në ambientet e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë apo një ambient tjetër të përshtatshëm.

2. Komisioni mblidhet dhe zhvillon veprimtarinë e tij mbi bazën e kërkesave të subjekteve, të përcjella nga Agjencia, për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore.

3. Mbledhjet e Komisionit thirren nga drejtori i Agjencisë ose nga kryetari i Komisionit dhe drejtohen nga kryetari. Në mungesë të kryetarit mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër në detyrë dhe në rast se janë më shumë se një, nga anëtari më i vjetër në moshë.

4. Njoftimi për vendin, kohën e mbledhjes, rendin e ditës, të miratuar nga kryetari i Komisionit, si dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", u dërgohen anëtarëve të Komisionit nga Sekretariati, të paktën 10 (dhjetë) ditë kalendarike përpara datës së zhvillimit të mbledhjes. Për raste të veçanta të miratuara nga drejtori Agjencisë apo nga kryetari me propozimin e më shumë se 3 anëtarëve të Komisionit, afati kohor reduktohet në jo më pak se 2 (dy) ditë pune.

5. Njoftimi i mbledhjes i dërgohet nga Sekretariati në formë shkresore dhe/ose elektronike në adresat e anëtarëve të Komisionit të depozituara nga secili anëtar pranë sekretariatit/Agjencisë në momentin e emërimit të tij. Data e njoftimit për mbledhje do të konsiderohet data e marrjes së njoftimit në formë shkresore ose e dërgimit të njoftimit në rrugë elektronike.

Neni 7
Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës.

3. Sekretariati i Komisionit harton listë-prezencën, e cila duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në fund të mbledhjes.

4. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit. Çdo anëtar i Komisionit ka vetëm një votë. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

5. Anëtari i Komisionit nuk mund të ndikojë në votimin e anëtarëve të tjerë.

Neni 8
Procesverbali i mbledhjeve dhe zbardhja e vendimeve

1. Dokumentimi i mbledhjeve të Komisionit bëhet nga sekretariati i Komisionit me anë të procesverbaleve. Sekretariati regjistron mbledhjet e Komisionit me qëllim zbardhjen e tyre dhe përgatitjen e procesverbalit. Në procesverbal duhet që të tregohet vendi ora e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes, pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit. diskutimet. propozimet. vërejtjet që bëhen në mbledhje, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultatet e votimit.

Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe kryetari, si dhe Sekretariati. Procesverbali depozitohet në protokollin e Agjencisë.

2. Vendimet e Komisionit zbardhen brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e mbledhjes dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe depozitohen në protokollin e Agjencisë. Kopja e vendimit që protokollohet në Agjenci kundërfirmoset edhe nga Sekretariati. Një kopje e vendimit, si dhe dokumentacioni i nevojshëm i dërgohet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për procedim të mëtejshëm kur kjo parashikohet në legjislacionin në fuqi.

3. Sekretariati i Komisionit ua dërgon vendimet dhe materialet e miratuara anëtareve të Komisionit dhe strukturave që janë ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e tyre, menjëherë pas protokollimit.

Neni 9
Sekretariati i Komisionit

1. Sekretariati caktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë në të cilin përcaktohen nominalisht personat që do të kryejnë funksionet e Sekretariatit dhe koha e angazhimit të tyre.

2. Sekretariati i Komisionit kryen dhe funksionet e asistencës dhe të mbështetjes logjistike duke lehtësuar në organizimin e mbledhjeve dhe administrimin e dokumentacionit përkatës të mbledhjeve.

3. Sekretariati i Komisionit ka për detyrë:

a) t'i paraqesë kryetarit materialet e përgatitura për mbledhjen e Komisionit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore dhe në vijim të miratimit nga kryetari, t'u dërgojë anëtarëve të Komisionit njoftimin dhe materialet përkatëse për mbledhje. Në çdo rast, nëse mbledhja është njoftuar, Sekretariati, edhe në mungesë të përgjigjes nga kryetari, ua përcjell dokumentet anëtarëve të Komisionit në limitin e afateve të parashikuara në këtë udhëzim për përcjelljen e tyre;

b) të drejtojë punën për përgatitjen dhe shpërndarjen e vendimeve dhe akteve të tjera të Komisionit;

c) të lehtësojë organizimin e mbledhjeve duke marrë masa për sigurimin e ambientit, logjistikës dhe infrastrukturës *online*;

d) të mbajë evidencat mbi prezencën e anëtarëve.

Neni 10
Konfidencialiteti

Vlerësimet dhe diskutimet që bëhen gjatë shqyrtimit të materialeve të paraqitura dhe marrjes së vendimeve në Komision janë konfidenciale dhe trajtohen si të tilla edhe pas përfundimit të funksionit të këtij Komisioni. Kryetari, anëtarët dhe Sekretariati nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit sipas formatit të përcaktuar në shtojcat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 11
Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit dhe mbledhja e parë e tij

1. Mbledhja e parë konstituive e Komisionit, thirret nga titullari i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, jo më vonë se 15 ditë nga momenti i marrjes së njoftimit të fundit për emërimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe pas datës së hyrjes në fuqi të akteve nënligjore që sigurojnë funksionimin e Komisionit dhe mundësojnë vendimmarrjen e tij.

2. Në mbledhjen e parë konstituive e Komisionit zhvillohet procedura e zgjedhjes së kryetarit, e cila drejtohen nga një nga punonjësit e Sekretarit të Komisionit, i përcaktuar nga titullari i Agjencisë, sipas parashikimit të nenit 4 të kësaj rregulloreje.

3. Punonjësit e Sekretariatit të Komisionit caktohen jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes konstitutive të Komisionit.

Shtojca 1

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet Z. / Znj. _____, në cilësinë e anëtarit të Komisionit **të** Licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e cannabis-it për qëllime mjekësore të cilët kanë akses në informacionin e mbajtur nga Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it.

Fusha e veprimit

Fushë veprimi i kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacione konfidenciale që njihen gjatë punës në Komisioni**n e** Licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e cannabis-it për qëllime mjekësore. Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia me këtë Komision dhe institucionin që më ka emëruar ka përfunduar.

Deklarata e konfidencialitetit

1. Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga Komisioni **i** Licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e cannabis-it për qëllime mjekësore apo Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it, përveç kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të anëtarësisë si dhe pas përfundimit të tij.
2. Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga ligji nr.9887, datë 10.03.2008 për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.
3. Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.
4. Marr përgjegjësinë e plotë që, në qoftë se konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarte të larta profesionale në _____.

_____ _____

Firma e anëtarit

_____

Data

Shtojca 2

FORMULAR DEKLARIMI
(i konfliktit të interesit)

Deklaruesi: _____

Unë _____, në cilësinë e anëtarit të Komisionit **të** Licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e cannabis-it për qëllime mjekësore, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar detyrën në këtë Komision.

Në çdo rast të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike do të deklaroj rast pas rasti konfliktin duke marrë përsipër detyrimet që vijnë nga një deklarim i tillë dhe penalitetet në rast të mosdeklarimit.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë_____

Emër Mbiemër

Nënshkrimi_____

AUTORIZIM
Nr. 1 , datë 22.10.2024

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

AUTORIZOJ:

1 Znj. Ledina Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të nënshkruajë, në emër dhe për llogari të ministrit çdo shkresë që lidhet me procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të paraqitura, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Për zbatimin e këtij autorizimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Ledina Beqiraj Agalliu.

Autorizimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

KËRKESË
Nr. 882/14, datë 18.11.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 702, datë 4.11.2022 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV, Valias'''.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat, të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 7 029 276 (shtatë milionë e njëzet e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 702, DATË 4.11.2022, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 KV, VALIAS'''

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)
												"ARË"				
	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	QYTETI	Z. KADASTRALE	NR. I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE (m²)	ARË (m2)	VOL	FAQE	SIPËRFAQJA E QË PRONËS SHPRONËSOHET	ÇMIMI SIPAS LACP (Lekë/m²)	VLERA (lekë)	VLERA TOTALE (LEKË)	
A	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	Q	R	S	X	Z
1	Devije dhe Kristina		Bushi	Tirane	2066	80/19	arë	4200	4200	23	38	1879	1822	3423538	3423538	
2	Ramazan dhe Sajmir	Sami	Bushi	Tirane	2066	80/37	arë	1700	1700	23	36	395	1822	719690	719690	
3	Arben	Sami	Bushi	Tirane	2067	80/38	arë	1200	1200			0	0	0	0	
4	Vjollca	Sami	Bushi	Tirane	2066	80/39	are	2600	2600	1	222	1584	1822	2886048	2886048	
SHUMA												3858		7029276	7029276	

KËRKESË
Nr. 1184/11, datë 19.11.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve *Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës*, loti 1&QMT, faza 2", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 103,096,750.18 (njëqind e tre milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim "ARRSH").

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

a) Për pasuritë e llojit "ndërtesë", është bërë bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, i ndryshuar, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive

pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit 'ndërtesë banimi ose jobanimi', i ndryshuar".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë ARRSH-së, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 103,096,750.18 (njëqind e tre milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë pikë tetëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN "PLOTËSIMI, RAKORDIMI DHE VAZHDIMI I PUNIMEVE *SHESHI SHQIPONJA – LUMI I TIRANËS,* LOTI 1 DHE QMT, FAZA 2", SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 662, DATË 13.10.2022

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	TË DHËNAT E PASURISË			TOKË TRUALL					TOKË ARË				NDËRTESË SOC. EK			OBJEKT BANIMI				VLERA TOTALE (LEKË)	SHËNIME
				Zona kadastrale	Numri Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera sipas preventivit lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi m²	Vlera lekë		
1	Gëzim	Pjetër	Aliaj	8310	2/20	truall	355.00											106.50	106.50	96,753.41	10,304,238.17	10,304,238.17	Trualli është shpronësuar në bazë të VKM-së nr. 662, datë 13.10.2022. Leje leg. nr. 1231954, datë 29.1.2020, godinë banimi 1 kt. sip. ndërtimi 98 m² sip. verande 8.5 m².
2	Arben	Mark	Ndoci	8310	10/804	truall	108.90	14.2	31,219.00	443,309.80												443,309.80	Leje leg. nr. 39204, datë 13.2.2013 godinë shërbimi 1 kt. sip. tot. e ndërtimit 62.9 m² për aktivitet.
3	Zef Ervin	Mark Mark	Susaj Hyso	8310	10/808	truall	264.80	44.1	31,219.00	1,376,757.90												1,376,757.90	Rivlerësohet pasuria sipas raport vlerësimit privat ne vlerën 24,478,923 lekë (198.400 euro) apl. nr. 3018, datë 21.1.2021).
4	Suri	Ramadan	Cala	8310	10/22	truall	296.80	31.3	31,219.00	977,154.70								87.60	87.60	96,753.41	8,475,598.72	9,452,753.42	Leje leg. nr. 997419, datë 11.05.2017 sip. kati përdhe 78.5 m² sip. verande 9.1 m², shpronësuar sipas VKM-së nr. 662, datë 13.10.2022 për 44.2 m² truall.
5	Edip	Qamil	Daçi	8310	10/974	truall	209.50	22	31,219.00	686,818.00												686,818.00	Leje leg. nr. 2875, datë 11.5.2010 godinë 2 kat. sip. ndërtimi kati përdhe 96 m² sip. verande 16 m² sip. ndërtimi kati i parë 112 m²
6	Fiqiri	Mer	Cena	8310	10/973	truall	170.00	23.3	31,219.00	727,402.70												727,402.70	
7	Gjin	Prek	Kola	8310	10/819	truall	259.00	23	31,219.00	718,037.00												718,037.00	Shpronësuar me VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022 për 139.8 m² truall dhe 90.4 m² objekt.
8	Hamit	Islam	Mollaj	8310	10/825	truall	78.00											43.70	43.70	96,753.41	4,228,124.02	4,228,124.02	Shpronësuar me VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022 për 21m² truall. Leje leg. nr. 914446, datë 29.04.2016 godinë banimi 1 kt. sip. ndërtimi 38.2 m² sip. verande 5.5 m².
9	Agron	Zef	Curri	8310	11/600	truall	74.80											217.70	217.70	96,753.41	21,063,217.36	21,063,217.36	Vendim nr. 1668, datë 19.08.2021 godinë banimi 3 kat sip. kt. përdhe 63.5 m² sip. verande 6 m² sip. kt. i parë 74.1 m² kati i dytë 74.1 m². Shpronësuar sipas VKM-së nr. 662, datë 13.10.2022 për 17m² truall.
10	Mitër	Zef	Curri	8310	11/200	truall	309.90											270.40	270.40	96,753.41	26,162,122.06	26,162,122.06	Leje leg. nr. 1231981, datë 30.1.2020 godinë banimi 2 kt. plus papafingo sip. kt. përdhe 109.1 sip. ndërtimi kt. pare 109.1 sip. shkalle 7.5 m² ndërtimi papafingo 37.2 m² sip. shkalle 7.5. Shpronësuar sipas VKM-së nr. 662, datë 13.10.2022 për 154 m² truall.
11	Lek	Gjon	Seferi	8310	10/979	truall	217.00	39.4	31,219.00	1,230,028.60												1,230,028.60	
12	Erjon Raimond Luljeta	Skënder Skënder Skënder	Shehi Shehi Haskurti	8310	2/477-ND	ndërtesë												276	276	96,753.41	26,703,941.16	26,703,941.16	Urdhër nr. 120181 i drejtorit për kufizim drejtoria ASHK Tiranë Veri kjo pasuri pozicionohet mbi pasurinë 2/477 vol. 30 f. 94, ZK 8310 Leje legalizimi nr. 120181, datë 21.5.2018 sipërfaqe totale kati përdhe 86.4 m² sip. totale kati pare 94.3 m² sip. totale kati i dytë 95.3 m².
	SHUMA TOTALE									**6,159,508.70**							**0.00**				**96,937,241.48**	**103,096,750.18**	
	Çmimet për pasuritë e llojit "truall" janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016																						
	Vlerësimet e llojit "ndërtesë", janë bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.2.2000, i ndryshuar.																						

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/11/26 15:43:55 +02'00'
fd7cefdf668f40749d4ab5c76aa817a02024112615434637031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)